



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Kuvendit Komunal Rahovec, mbajtur më **4 korrik 2011**, me fillim në ora 10, në sallën e KK-së. Të pranishëm: këshilltarët KK-së, z.Smajl Latifi, kryetar i Komunës, z.Hazër Tara, nënkryetar i Komunës, drejtorët e drejtorive, Ismet Berisha, drejtor i Njesisë së ujërave, përfaqësuesit e KFOR-it, OSBE-së, KDI-së dhe mediat. Mbledhjen e ka udhëhequr Kujtim Popaj, kryesues i Kuvendit dhe për mbledhjen e sotme ka propozuar këtë

REND DITE

1. Shqyrtimi i Projektligjit për fshatin Hoçë e Madhe,
2. Njoftim mbi gjendjen e furnizimit me ujë të pijes në Komunën e Rahovecit,
3. Shqyrtimi i Pasqyrës financiare dhe Raportit të Auditorit të Pavarur (të përgjithshëm) për vitin 2010,
4. Shqyrtimi i projekt Aktvendimit për aprovimin e kërkesës së Gëzim Jahir Shala nga Xërxa, për lejimin e ndërrimit të patundshmërisë,
5. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve.

Feim Fetoshi – në cilësinë e këshilltarit të KK-së dhe të AAK-së shprehi shqetësimin për numrin zyrtar të shpallur të banorëve të Komunës së Rahovecit nga Enti i Statistikave të Kosovës. Në bazë të informatave që kam marr kemi një numër në Komunën e Rahovecit që ka vetëm 55.053 banorë. Kjo shifër është qesharake, është e dëmshme në aspektin politik dhe po ashtu e dëmshme dhe me pasoja afatgjate edhe në aspektin e zhvillimit ekonomik. Po përmendi vetëm disa shifra logjike për të cilat nuk ka nevojë të jesh as ekspert i statistikës, as i matematikës që të kuptosh që këtu të kemi të bëjmë me një lëshim drastik. Në shtator të vitit 2010 KQZ ka dalë me një listë të votuesve në Komunën e Rahovecit 49.321, ne e dimë që KQZ zakonisht shifrat i merr nga librat e regjistrimit civil dhe ato janë zyrtare, po ashtu e dimë për një lëshim në këto lista që kemi parë aty këtu ndonjë person që është në këto lista që për fat të keq ka vdekur. Në bazë të normës së mortalitetit në Kosovë kjo shifër nuk do të duhej të ishte mbi 2-3%. Po marr një shifër ekstreme dhe po supozoj që edhe 10% të atyre që kanë qenë në atë listë që janë të vdekur dhe dalim në një shifër prej 44.389 banorë të gjallë mbi moshën 18 vjeçare në Komunën tonë. E dimë ne të gjithë, e tërë Kosova dhe e tërë bota që në Kosovë moshë mesatare është rreth 24 vjeç dhe nëse bazohemi në këtë atëherë në Rahovec do të duhej të kishim së paku 79.000 banorë **Nahit Elshani** – ky shqetësim që është ngritur është mirë që sot të mos e debatohet për faktin se ne nuk kemi rezultate zyrtare të konfirmuara dhe në momentin që vijnë rezultatet zyrtare atëherë është mirë të bëjmë një debat në Kuvendin e Komunës, por jo sot për faktin se kemi mjaft pika dhe ende nuk kemi rezultat zyrtar të konfirmuar nga Enti i Statistikave. **Smajl Latif**, Kryetar i Komunës – regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave është një projekt që e ka përfshirë e gjithë Kosovën dhe shqetësimet të cilat u ngritën këtu janë me të drejtë sepse edhe ne kemi pritur më shumë. Kam shifrën e saktë të asaj që është rezultat preliminar ndërsa rezultatet përfundimtare do të jepen pas 2-3 vite dhe është mirë që të kemi parasysh edhe disa situatat të cilat lidhen me ligjet të cilat ne si Komunë jemi të obliguar me i zbatuar. A është i saktë ai numër që e paraqiti Feimi apo jo mbetet të shihet sepse mund të jetë përafërsisht një rezultat preliminar. Ndërkaq, unë ju them që me përgjegjësi më të madhe janë kryer të gjitha obligimet në bazë të kërkesave të parashtruara nga Komisioni qendror i regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave. Pra, në qoftë se ka faj Komuna e Rahovecit, ka faj edhe krejt Kosova. Është mirë të presim rezultatet edhe preliminare edhe përfundimtare sepse shpresoj që rezultatet përfundimtare do t'i tejkalojnë ato shifra që u përmendën këtu.

Kryesuesi – meqë ende nuk kemi raport zyrtar lidhur me regjistrimin e popullsisë dhe në momentin kur i marrim rezultatet zyrtare mund të caktojmë një pikë të veçantë të rendit të ditës dhe të diskutojmë.

Pas hedhjes në votim kryesuesi konstatoi se **rendi i ditës për mbledhjen e sotme aprovohet njëzëri.**

1. Shqyrtimi i Projektligjit për fshatin Hoçë e Madhe.

Kryesuesi i Kuvendit **Kujtim Popaj** – këtë pikë e kemi vënë në shqyrtim pasi që është kërkuar në seancën e kaluar nga Ju që e njëjta të diskutohet. Ne këtë pikë e kemi diskutuar edhe në KPF kështu që të gjithë anëtarët e KPF e kanë refuzuar këtë Projektligj sepse është i dëmshëm për Komunën e Rahovecit, republikën e Kosovës e gjithashtu edhe për qytetarët që jetojnë në Komunën e Rahovecit. Komiteti për politikë dhe financa ka dalë me një deklaratë të cilën e kemi edhe në WEB faqen e Komunës që është funksionale si dhe për media. Gjithashtu me kërkesë të KPF kemi kërkuar që sot në këtë mbledhje të merr pjesë edhe Ministri i ambientit dhe planifikimit hapësinor, mirëpo ai më është përgjigjur se nuk mund të merr pjesë për shkak të obligimeve që ka.

Smajl Latifi, Kryetar i Komunës – Rahoveci ka kaluar nëpër një periudhë të vështirë në luftën e fundit, rezultojnë rreth 1.000 të vrarë e të zhdukur, ndërsa dëmet materiale kanë qenë të pallogaritshme. Pra, kjo liri i kushtoi shumë shtrenjtë kësaj komune. Pas përfundimit të luftës të gjitha qeveritë lokale pa përjashtim janë munduar të tejkalojnë pasojat shkatërrimtare të luftës dhe të krijojnë kushte për jetë të qetë të qytetarëve pa dallim etnie, gjinie apo besimi fetar. Popullata e kësaj Komune ditëve të fundit është shumë e shqetësuar lidhur me idenë e një Projektligji për fshatin Hoçë e Madhe, fshat ky aktualisht i banuar me serb, por që nuk ka qenë kështu në të kaluarën jo fort të largët. Banorët lokal dhe autoritetet serbe kanë përdorur të gjitha mjetet në dispozicion që ky fshat të jetë etnikisht i pastër. Në këto rrethana popullata shumicë janë munduar të krijojnë kushte për shërimin e plagëve të së kaluarës dhe të krijojnë kushte për ecje

përpara. Deri më tani janë bërë përpjekje të mëdha për integrimin e banorëve të këtij fshati në jetën institucionale publike dhe janë shënuar arritje inkurajuese në këtë drejtim. Edhe ky fshat nuk ka mbetur jashtë vëmendjes institucionale dhe janë hartuar projekte investuese me qëllim të rritjes së mirëqenies të banorëve të fshatit. Shqetësimi i përbashkët i të gjithë banorëve të Komunës së Rahovecit është mungesa e perspektivës për të rinjtë si pasojë e numrit të madh të papunëve, në këto rrethana kemi bërë përpjekje për gjetjen e mundësive për uljen e papunësisë dhe si rrjedhojë e dhe të varfërisë në Komunën tonë. Këto përpjekje janë bërë menjëherë pas luftës e deri tani dhe vazhdojnë të bëhen edhe tani e tutje. Mirëpo, tendencat e fundit për prishjen e këtij ritmi të jetës kanë qenë të fuqishme me hedhjen në skenë të Projektligjit për Hoçën e Madhe. Monumentet e kulturës serbe tashmë gëzojnë imunitet dhe janë të mbrojtura nga Shteti i Kosovës me Ligjin mbi Trashëgiminë Kulturore të Kosovës, që është nxjerr në frymën e pakos së Ahtisarit edhe pse lidhur me këtë çështje gjendja lë shumë për të dëshiruar dhe nuk jemi të interesuar që tani të hyjmë në debate sepse janë ekspert e trashëgimisë ata që i njohin fare mirë dhe kuadrat e shumta që ka Komuna e jonë por edhe Kosova që mund të fletë më së miri se cila është baza ose themelet e kësaj trashëgimie. Ne shtrojmë pyetje? Kujt ju desht ky Projektligj tani. Kemi shumë argumente për të kundërshtuar këtë Projektligj ngase përpjekjet për izolimin, enklavizimin dhe getoizimin e banorëve të fshatit Hoçë e Madhe janë kundër njerëzore. Ne duam të kemi shoqëri të integruar dhe jo të izoluar, në esencë ky Projektligj është thellësisht politik dhe synon krijimin e zonave serbe të interesit, duke cenuar edhe tërësinë tokësore të Republikës së Kosovës rrjedhimisht dhe duke cenuar rëndë integritetin dhe sovranitetin e vendimmarrje të autoriteteve komunale të Rahovecit. Kjo bie ndesh me vetë planin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e çështjes së Kosovës të njohur si Plani i Ahtisarit. Ky plan në asnjë nen nuk parasheh që Hoça e Madhe të ketë ligj të veçantë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Ky Projektligj nuk ka bazë në dokumentet juridiko-politike të Kosovës dhe cenon tërësinë territoriale të Komunës së Rahovecit, duke krijuar barrierë për qarkullimin e lirë të njerëzve në këtë rajon. Këshilli i fshatit i ashtuquajtur këshilli i ekspertëve mund të sjell në dyshim realizimin e projekteve gjithëpërfshirëse komunale dhe mund të pengojë zhvillimin e gjithëmbarshtëm ekonomik e social të Komunës. Formimi i Këshillit të fshatit është në kundërshtim me nenin 10 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe paraqet organ paralel komunal karshi kryetarit të Komunës dhe Kuvendit komunal gjë që mund të paralizojë jetën institucionale në Komunën tonë. Këshilli i fshatit do të ketë kompetenca të zgjeruara dhe asnjë aktivitet i Komunës nuk do të jetë i mundur të realizohet pa pëlqimin e tyre gjë që krijon epërsi vendimmarrëse në raport me institucionet komunale. Çdo veprim i institucioneve komunale do të jetë i varur nga vullneti i një grupi njerëzish me orientime thellësisht politike dhe kjo do të nxis kundër reagim, prandaj miratimi i këtij Projektligji do të nxisë armiqësitë e fjetura dhe mund të krijoj rrethanat tejet të pakëndshme në raportet ndëretnike. Shoqëria civile me të drejtë ka shprehur hapur mospajtimin e vet me këtë Projektligj dhe mund të pritet reagimi i fuqishëm në këtë drejtim, jo vetëm i shoqërisë civile, tashmë po shkallëzohet reagimi sepse edhe Kuvendi komunal dhe KPF por edhe shumë aktorë në shoqërinë tonë pothuaj se janë të gatshëm për të gjetur modalitete sa më të mira, sa më të përshtatshme për të reaguar kundër këtij Projektligji. Prandaj, i bëjmë thirrje Kryeministrit të Republikës së Kosovës z.Hashim Thaçi, Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës z.Jakup Kasniqi, Shefit të Zyrës ICO Xhifonit, Xhentilit, Piter Fajt, Ministrit të planifikimit hapësinor dhe mbrojtjes së mjedisit z.Dardan Gashi dhe të gjithë aktorëve tjerë, po ashtu edhe kryetarit të Komisionit që merret me adresimin e këtij Projektligji që në këtë rast është z.Nahit Hasani dhe gjithë deputetëve të Komunës tonë që janë anëtar të Kuvendit të Kosovës dhe deputetëve të rajonit të Prizrenit e rajonit tonë që të llojnë kundër këtij Projektligji për shkak se aprovimi ose procedimi i mëtejshëm i këtij Projektligji do të prodhojë një situatë që do të ndikojë në prishjen e klimës pozitive në Komunën e Rahovecit. Nëse ndodh e kundërta, në qoftë se nuk e marrin parasysh këtë apel demokratik, këtë apel tonin qartë si autoritete komunale, si Kuvend komunal, si qytetarë të shqetësuar të kësaj Komune, për ngjarjet e pakëndshme dhe me pasoja afatgjata, nuk do të binin në institucionin e Kryetarit të Komunës dhe në institucionin e autoriteteve komunale, që do të thotë përgjegjësitë do t'i mbajnë ata që marrin përsipër me aprovu Projektligjin dhe nuk mbajnë asnjë përgjegjësi në qoftë se situatat del jashtë kontrollit institucional. Çdo tendencë për të relativizuar rreziqet e mundshme nga ky Projektligj do të kishte pasojat e paparashikuara për të ardhmen e banorëve të Komunës së Rahovecit. Shpresojmë që nga kjo situatë e krijuar të përfitojmë të gjithë ne dhe shprehim edhe njëherë gatishmërinë tonë për krijimin e kushteve më të mira të jetesës për të gjithë banorët e Komunës së Rahovecit, pa dallim etnie e përkatësie fetare. Dëshiroj t'ju shpreh edhe njëherë gatishmërinë time si Kryetar Komune që notoftë se ju do t'na jepni mundësi që unë me shefat e grupeve parlamentare dhe me juve të vrapojmë për të biseduar me shefin e Grupit Parlamentar të PDK-së në nivel qendror, me shefin e Grupit Parlamentar të AAK-së, me shefin e Grupit Parlamentar të LDK-së, me Kryetarin e Komisionit për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mbrojtje të mjedisit, planifikim hapësinor Nahit Hasanin, me Zyrën e ICO, në mënyrë që t'i adresojmë qartazi këto shqetësime dhe këto kundërshtime të bazuara në fakte dhe argumente për ta evituar rrezikun e mundshëm.

Salih Hoti – pajtohem me deklaratat në emër të KPF dhe të kryetarit të Komunës dhe ato duhet të mbështeten fuqimisht, ne këtë nuk e bëjmë për shkak të deficitit patriotik ose për çështje sa për t'u duk në media se po bëjmë një reagim, mirëpo vërtet konsideroj që është më se e domosdoshme që gjëra të tilla thjeshtë të stopohen njëherë e përgjithmonë. Shumëkush nga ne dhe nga opinioni në Kosovë kanë menduar që me përfundimin e bisedave për zgjidhjen e statusit të Kosovës nën udhëheqjen ose në mandatin e Kombeve të Bashkuara të cilat i ka udhëhequr Marti Ahtisari është menduar që çështjes së statusit të Kosovës i është vënë pikë njëherë e përgjithmonë si dhe çështjes së zgjidhjes së problemeve të pakicave sidomos të pakicës serbe. Konsideroj që me këtë rast dikush e ka për qëllim që çështja e statusit të Kosovës të mos përfundojë asnjëherë dhe vazhdimisht të ketë lëshime deri në pakufi. Kjo është edhe si rezultat i mos seriozitetit tonë e sidomos të institucioneve qendrore të cilat për të treguar që janë tolerantë ose thjeshtë nuk kanë imunitet me këmbëngulë

në ato çështje të cilat vërtetë jemi përcaktuar edhe si opinion dhe si popull. Konsideroj që me këtë rast rreth këtij Projektligji për të cilin po debatohet këtu janë disa tendenca politike dhe nuk është qëllimi që të zgjidhen çështja e kulturës ose e monumenteve kulturore në Komunën e Rahovecit po edhe në Kosovë. Kahjet politike janë duke shkuar në tri drejtime: e para, tendenca e serbeve dhe një pjesë e bashkësisë ndërkombëtare kanë për qëllim që veriu e Kosovës me një periudhë afatmesme ose afatgjatë me shkëput prej Kosovës, tendenca e dytë është që brenda pjesës qendrore dhe jugore të Kosovës të krijohen kushtet që serbë të kenë një lloj autonomie substanciale të padeklaruar dhe pse jo me këtë rast kanë filluar edhe me zgjerimin edhe të komunave të Reja. Rahoveci është vetëm si mostër, nëse në Rahovec kalon ky test të jeni të bindur mostër të tillë kanë me bërë edhe në qytetet tjera të Kosovës dhe çdo lagje e qyteteve ose çdo lokalitet i vogël do të ketë një lloj mini Komune. Të gjitha këto janë me tendencë këtu të tregohet që është një mos funksionalitet në nivel të Kosovës po pse jo edhe në nivelin komunal. Këtu i kemi disa nenet të cilat janë kontradiktore, për të cila nene nuk ka kompetencë Kuvendi as Qeveria komunale me i zgjidh, mirëpo i drejtohen njëfarë Komisioni ZVM që është në nivel qendror me çka nënkupton që na kemi me pasur probleme të vazhdueshme për mospajtime të ndryshme në aspektin lokal. Ky Projektligj ka edhe implikime buxhetore, këta këshilltar komunal kanë me u paguar dhe kanë të njëjtin tretman sikur ne që jemi këtu si dhe do të krijohen shpenzime tjera materiale të cilat nevojiten për funksionimin e këtij organi.. Ju ftoj juve si këshilltar komunal që të nxjerrim një konkluzion të qartë dhe t'ju drejtohem i të gjitha institucioneve dhe ky Projektligj të bllokohet që në start.

Nahit Elshani – do të paraqes mendimin e Grupit të këshilltarëve të LDK-së lidhur me këtë draft Ligj për Hoçën e Madhe, por para se të bëjë atë kam disa vërejtje në deklaratën e cila është formuluar e cila ka dalë nga KPF ku në fillim thuhet kundër këtij Projektligji të sponsorizuar nga Ministria e mjedisit dhe ambientit, jo e sponsorizuar por e draftuar. Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor është draftuese e këtij Ligji. Pastaj, ne anëtarët e KPF e shohim të paarsyeshme, jo të paarsyeshëm por e kundërshtojmë draftimin e mëtutjeshëm të këtij Ligji. Më poshtë prapë thuhet i cili nuk është në përputhje me LVL e duhet të jetë është në përputhje me LVL dhe Statutin e Komunës dhe krejt në fund ku thuhet apelojmë tek Ministria e ambientit dhe planifikimit hapësinor si dhe Komisioni parlamentar te deputetet e Republikës së Kosovës në mënyrë që ta parandalojnë aprovimin. Jo ta parandalojnë por ta ndërpresin draftimin e mëtutjeshëm të këtij Ligji. Prandaj kërkoj që të plotësohet me këto përmirësime kjo deklaratë.

Ne si Grup i këshilltarëve të LDK-së shprehim shqetësimin tonë lidhur me veprimet e Qeverisë së Kosovës respektivisht MMPH e cila ka qenë draftuese e këtij Ligji dhe aq më keq për mos transparencën e treguar nga ky institucion qeverisës apo nga kjo Ministri, kur dihet fakti që dy vite kjo Ministri punon në draftimin e këtij Ligji ndërsa opinioni i gjerë respektivisht opinioni i Komunës së Rahovecit është i njoftuar tani para një muaj. Ne e kundërshtojmë këtë draft Ligj për Hoçën e Madhe dhe kërkojmë nga kjo Ministri që ta ndal draftimin e menjëhershëm të këtij Ligji. Po ashtu ky Projektligj është në kundërshtim të plotë me LVL si dhe me Statutin e Komunës. Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale neni 4.6 e qartëson bashkëpunimin apo bashkëveprimin e Komunës me fshatrat dhe me lagjet e caktuara. Ky Projektligj e çrregullon sistemin administrativ dhe rregullues të Komunës së Rahovecit si dhe synon që përmes zgjedhjes së Këshillit të fshatit të legalizojë strukturat ilegale të cilat kanë vepruar në fshatin Hoçë e Madhe. Kur them strukturat ilegale e kam fjalën për strukturat paralele të cilat qysh pas luftës kanë funksionuar dhe fatkeqësisht funksionojnë edhe sot në Hoçë të Madhe dhe janë pengesë për integrimin e komunitetit serb në jetën institucionale të Rahovecit. Andaj tentativa për të krijuar një Ligj të tillë dhe për të zgjedhur një Këshill të fshatit është kjo që ka të bëjë me legalizimin e këtyre strukturave paralele të fshatit Hoçë e Madhe. Po ashtu ky Projektligj synon që të legalizoj mini enklavën e Hoçës së Madhe e cila ka funksionuar ilegalisht dhe funksionon edhe sot në mënyrë ilegale, do të thotë është funksionale mini enklava e Hoçës së Madhe dhe ne që jetojmë në Komunën e Rahovecit e dimë qartë se Hoça e Madhe sot e kësaj dite nuk e pranon realitetin e ri të krijuar në Kosovë, nuk i pranon institucionet komunale dhe ajo vepron dhe ushtron funksionet e veta në bazë të ligjeve të Serbisë. Mendojmë që ky Ligj do t'i thellojë ndasitë në baza etnike në Komunën tonë dhe do të pengojë integrimin e minoritetit serb në jetën institucionale të Komunës sonë. Ne jemi për mbrojtjen e monumenteve kulturore e fetare të Hoçës së Madhe po njëherësh kërkojmë që kjo e drejtë dhe kjo mbrojtje t'ju ofrohet të gjitha monumenteve, kulturore, fetare dhe historike në Komunën e Rahovecit, duke filluar nga qyteti por edhe nëpër fshatra. Mendoj që të gjitha objektet kulturore, fetare në Hoçë të Madhe kanë qenë të mbrojtura me shekuj dhe asnjëherë nuk kanë qenë të cenuara dhe të rrezikuara, përkundrazi një objekt kulturor dhe me vlera historike i cili është në Hoçë të Madhe që është kulla e Shaqë Hoçës, ajo i është lënë mëshirës së kohës dhe për çdo ditë dëmtohet sepse nuk është e mbrojtur nga vetë serbet lokal të cilët jetojnë në Hoçë të Madhe.

Kryesuesi - vërejtjet që u dhanë, unë jam bazuar në diskutimet e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe në bazë të asaj është përpiluar kjo Deklaratë dhe ju në WEB faqet e juaja i keni pasur afat prej 4 ditësh që të jepni sugjerime, por i vetmi Feim Fetoshi ka dhënë sugjerime të cilat janë marr parasysh.

Xhemali Haxhimustafa – ndjej obligim moral që sot para kolegëve të mi dhe para qytetarëve të Komunës së Rahovecit si individ sikur edhe ju që kemi marr vota për të ardhur këtu, të shprehë indinjatën dhe revoltë që na servohen gjerat të cilat nuk mund të kapërdihen në këtë rast. E di që më ka rastis fati së bashku me disa kolegë që jemi këtu, po e përmendi vetëm Salih Hotin, por jam edhe shumë të tjerë këtu, që menjëherë pas luftës kemi qenë anëtarë të Këshillit të Përkohshëm Komunal. E di se çfarë përpjekje kemi bërë që të integrojmë komunitetin serb në jetën e përgjithshme të Komunës së Rahovecit. Këtë e thashë me qëllim se Komuna e Rahovecit dhe Rahoveci ka përjetuar shumëçka gjatë viteve të cilat edhe është vështirë t'i përmend njeriu e lëre më t'i kujtoj. Përkundrazi asaj kemi gjetur forcë morale dhe duke pasur parasysh edhe varrat të cilat i kanë pasur motrat tona, nënat, baballarët, ende të freskëta, ne i kemi vetes të drejtë që

të përballemi edhe me atë kërkesë të faktorit ndërkombëtar, gjithmonë me shpresë se bile së paku sot nuk do të kemi raste dhe probleme të tilla si që është ky sot. I ftoj kolegët e mi këtu në qoftë se nuk keni pasur kohë, edhe njëherë kthehuni dhe analizoni këtë Ligj nëpër shtëpitë e juaja dhe do të shihni se është turp ai që e ka draftu dhe është turp ai që ka menduar se mundet aq lehtë nën plaf të kalojë ky Ligj dhe të na servohet si një akt nënligjor dhe plus me turp thotë konform Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale. Nuk ka ligj mbi ligj në qoftë se nxirret një akt nënligjor duhet të thirret në emër të një dokumenti më të lartë se ky. Në një farë forme vetvetiu vetëm kur thuhet në bazë të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të jep të drejtë se çka është ky ligj dhe kjo mjafton për neve që të kuptojmë këtë. I lus të gjithë ata të cilët kanë mundësi t'na dëgjojnë edhe nëpërmjet deklaratës të cilën e kemi dhënë më herët. Në aspektin juridik është thyerja e kurrizit pa zhurmë të Komunës së Rahovecit. Askush prej nesh që jemi këtu sepse thanë njerëzit me argumente të gjalla nuk ka kundër as trashëgimisë kulturore, as fetare e as shpirtërore të askujt, bile nuk është vetëm rasti i Hoçës po janë rastet e shumta nëpër Kosovë që ne kemi qenë aq të përkushtuar sa që kemi ruajt çdo kulturë ndoshta edhe më herët me përkushtim më të madh. Gjatë krejt historisë të ish socializmit dhe pas nuk tentuam as më të voglën gjë t'i bëjmë komunitetit që jeton këtu lidhur me trashëgiminë kulturore. Në bazë të LVL Komuna ka të drejtë të lidh marrëveshje të veçanta me fshatra apo një lokalitet ekskluzivisht për lëmin e caktuar që askush nuk është kundër asaj. Ka pasur draftuesi mundësi që të bëjë këtë Ligj shumë funksional, të bëjë këtë Ligj shumë të kufizuar dhe të mos vij në këtë formë e cila do të jetë irrituese për secilin që është jashtë këtij Kuvendi e jo vetëm ne që jemi këtu. Planit të Ahtisarit i ka kaluar mandati dhe pse kthehemi prapa për një gjë të cilën dikush nuk e ka dashtë në kohën e caktuar dhe sot duhet medoemos të kthehemi se vetëm që të jemi pak më të pranueshëm për disa rrethe të ngushta të përfaqësuesve ndërkombëtarë. Ka shumë pika në këtë draft Ligj të cilat neve na jep të kuptojmë edhe pse Hoçën e Madhe nuk e quajnë Komunë, ajo do të jetë një njollë në qoftë se jo me emër, me ingerenca do të jetë njëfarë komune në këtë territor të vogël të Komunës së Rahovecit. Kategorikisht e kundërshtoj një Ligj të formës së këtillë që Kuvendi i Kosovës të aprovoj në lidhje me Hoçën e Madhe duke mos ç'vlerësuar tendencat për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe asaj shpirtërore të çdo komuniteti dhe të çdo qytetari që jeton në Kosovë. Për ne është e papranueshme dhe për ne është kjo një thikë e cila do të ketë pasoja të mëvonshme edhe për shëndetin edhe për të ardhmen tonë të përgjithshme.

Feim Fetoshi – ky Projektligj përpos asaj që u tha është një ofendim i thellë për popullatën shqiptare të Komunës së Rahovecit. Popullata shqiptare e kësaj Komune ka qenë shembull për të mirë se si duhet të punohet në integrimin e pakicave kombëtare. Asnjëherë nga çlirimi e këtij, qoftë mediat apo institucionet asnjëherë nuk kanë pasur ekzistuar ndonjë problem sado i vogël në mes të popullatës shqiptare dhe pakicës serbe. Kjo është argument më i fuqishëm se kjo popullatë edhe pse nuk harron por din të shtroj dorën e bashkëpunimit, ashtu si ka shtruar dorën e bashkëpunimit që së bashku të jetojmë dhe të punojmë për të ardhmen tonë të përbashkët. Ky Ligj nuk është as në interes të vetë qytetarëve të fshatit Hoçë e Madhe, por është në interes të strukturave paralele që kanë ekzistuar dhe ekzistojnë në këtë fshat. Ata për të argumentuar ekzistencën e tyre edhe më tutje natyrisht që duhet të llobojnë dhe të punojnë që diç e tillë të realizohet në mënyrë që të arsyetojnë ekzistencën e tyre. Diskriminimi pozitiv që po i bëhet pakicës serbe gradualisht po shndërrohet në diskriminim të vërtetë të vetë pakicës serbe, sepse konsideroj se nëse kjo realizohet edhe pse në dukje disave i merr mendja që ata përfitojnë diçka, në realitet unë mendoj se më shumë humbin. Vetë marrëveshja para dy dite në mes të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe institucioneve të Republikës së Serbisë për lëvizje të lirë, direkt ky Ligj është në kundërshtim me këtë, sepse vetvetiu në vend që të avancohet lëvizja e lirë, me këtë Ligj rrezikohet lëvizja e lirë. Pra, ajo që është punuar 12 vite në Komunën e Rahovecit rrezikon të shembet. I ftoj qytetarët e Hoçës së Madhe, qytetarët të cilët jetojnë nga djersa e vetë, qytetarët të cilët mendojnë edhe në të ardhmen të jetojnë në mënyrë të denjë dhe nga puna e tyre e ndershme e jo nga fondacionet e ndryshme që paguajnë qendrat e ndryshme politike për paralizimin e qëllimeve të ndryshme politike që ata së pari duhet të dalin kundër kësaj, kundër këtij Projektligji sepse është në të mirën e tyre. Natyrisht që në aspektin tonë si popullatë shumicë që jemi në Komunën e Rahovecit dhe si këshilltar komunal ne nuk do të lejojmë dhe duhet të dimë të mbrojmë ashtu siç kemi ditë çdo herë të mbrojmë integritetin territorial politik dhe ekonomik të qytetarëve dhe të Komunës së Rahovecit. Sa i përket trashëgimisë kulturore është mëkat që të thuhet që bëhet diçka në mbrojtje të trashëgimisë kulturore. Edhe në kohën e luftës me gjithë masakrimet që ka përjetuar kjo popullatë trashëgimia kulturore është ruajtur. Pra, trashëgimia kulturore nuk është vetëm e serbëve por trashëgimia kulturore është e të gjithëve që jetojnë në Komunën e Rahovecit dhe ajo duhet të mbrohet nga të gjithë dhe tek të gjithë. Është e mjerueshme të thuhet që vetëm në një vend ekziston trashëgimia kulturore dhe aty duhet të mbrohet. Trashëgimia kulturore në Komunën e Rahovecit ka në mbar territorin tonë dhe siç u tha nga kolegu në fshatin Hoçë e Madhe ekziston edhe kulla e Shaqë Hoçës e cila ju ka lënë vetëm mëshirës. Ftoj të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës posaçërisht deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që në asnjë mënyrë të mos i japin dritën e gjelbër këtij Projektligji sepse me këtë cenohet në mënyrë të drejtpërdrejt vetë popullata shqiptare, popullata serbe dhe bashkëjetesa e krijuar me mund që e kemi arrit deri tani.

Sinap Ejupi – edhe ne si Grup parlamentar i AKR-së nëpërmjet përfaqësuesit tonë në Komitetin për Politikë dhe Financa jemi deklaruar qartë kundër këtij Projektligji, e mbështesim deklaratën e Kryetarit dhe të Kryesuesit me përmirësimet që u cekën. Kundërshtimi jonë në Komitet ka qenë i ashpër, ka qenë i qartë kundër këtij Projektligji të draftuar MMPH. Ky Projektligj paraqet kancerin në jetën institucionale dhe të përditshme të Komunës së Rahovecit. Kjo është një politikë e cila vjen prej qendrave më të larta konkretisht prej Beogradit, është një politikë e cila synon shkatërrimin jo vetëm të Komunës së Rahovecit respektivisht zgjerimin e territoreve të veta të bazuara në perspektivë. Në emër të Grupit të AKR-së kërkoj nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, posaçërisht nga deputetët e rajonit të Rahovecit dhe në përgjithësi, që në

mënyrë kategorike që të stopojnë këtë Projektligj dhe të mos hyhet fare në Kuvendin e Kosovës dhe do t'i përkujtoja deputetët e Kuvendit të Kosovës që të mos bëjnë më prova me Komunën e Rahovecit sepse çdo nen i këtij Projektligji është më i keq se tjetri. Ndoshta do të ishte fati më i madh po të ishte formuar një Komunë prej disa fshatrave se sa ky Projektligj sepse nuk dihet a ka të bëjë me Komunë apo mini Shtet në Komunë, sepse ka aq kompetenca sa që duke i njohur metodat e disa grupeve të cilat jetojnë aty, mendoj se këta do të paraqesin problemet e vazhdueshme edhe në organizimin e hapësirës të Komunës së Rahovecit në të ardhmen.

Avdullah Kryeziu – pajtohem me deklaratën e KPF, ky Projektligj për Hoçën e Madhe po më përkujton një kohë të kaluar ku një bashkësi është përkrah dhe ju kanë dhënë shumë të drejta ndërsa u janë marr të drejta bashkësive tjera. Ky Projektligj bie ndesh drejtpërdrejt me LVL me nenin 34.4, nenin 12.4 pika c) e po ashtu bie ndesh me Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 4 qershor 2008, nenit 10.4, 52.2 pika a) dhe po ashtu bie ndesh me Statutin e Komunës së Rahovecit. Ne si Komunë kemi të drejtë të hartojmë një Rregullore që t'i japim këtë të drejtë të gjitha bashkësive lokale në territorin e Komunës së Rahovecit dhe krejt është normale që si bashkësi lokale edhe fshati Hoçë e Madhe të ketë këtë të drejtë, mirëpo jo t'i cungohet e drejta bashkësive tjera lokale. Ky Projektligj mendoj se është hartuar nga propozuesi MPH në mënyrë të padrejtë, antikushtetuese dhe në mënyrë antiligjore. Siç ceka më lartë ne mundemi t'i japim të drejtë edhe bashkësive tjera lokale. Cilat janë detyrat dhe përgjegjësitë e bashkësive të bashkësive lokale të tjera e jo vetëm të bashkësisë në fshatin Hoçë e Madhe. Detyrat dhe të drejtat janë të njëjta për të gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit. Këshillat e bashkësive urbane ose vendbanimeve lokale kryejnë këto detyra: kujdesen për planifikimin urban dhe rural; kujdesen për furnizimin me ujë; rregullimin e kanalizimit; drenazhimin; ofrimin e shërbimeve publike efikase; kujdesen që qytetarëve t'ju ofrohet mbrojtja shëndetësore primare; kujdesen për mbrojtjen lokale të ambientit; për zhvillimin e turizmit; kujdesen edhe për të gjitha problemet që i kanë bashkësitë tjera lokale, mirëpo kjo bëhet në koordinim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutin e Komunës së Rahovecit, e jo të bëhet në mënyrë diskriminuese vetëm për një bashkësi lokale. Ky Projektligj i MPH është bazuar në LVL, dispozitat e Statutit të Komunës dhe është ndërhyrje e drejtpërdrejt në LVL dhe është shkelur Kushtetuta dhe autonomia e komunave të Kosovës në këtë rast Komunës së Rahovecit. Ne në pamundësi për shkak të implikimeve buxhetore, por ne patjetër duhet t'i japim të drejtë bashkësive lokale që t'i kenë këto të drejta por edhe Bashkësisë lokale në Hoçë të Madhe. Më vjen shumë keq dhe shpreh një shqetësim për faktin se ky Projektligj ka filluar të përgatitet në kohën e ish kryetarit të Komunës dhe asnjëherë ky Kuvend nuk është njoftuar që është në përgatitje e sipër një Projektligj i tillë diskriminues për banorët e Komunës së Rahovecit dhe asnjëherë ky Kuvend nuk është njoftuar që ekziston një Projektligj i tillë i cili me të vërtetë do të na shkaktoj telashe në këto hapësira në të cilat jetojmë ne.

Lumturije Hoti – në KPF kam shprehur mendimin tim kundër këtij Projektligji dhe edhe sot po them se i njëjti është në kundërshtim me Kushtetutën, me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës dhe nëse vjen deri te miratimi i këtij Ligji, ne si Komunë duhet të përdorim mjetet juridike. I bëj thirrje deputetëve të Parlamentit të Kosovës që të shqyrtojnë mirë këtë Projektligj dhe të njëjtin të mos e miratoj.

Xhihad Vuçitërna – Partia e Drejtorisë dhe unë si përfaqësues i kësaj partie e kundërshtojmë miratimin dhe implementimin të këtij draft Ligji për arsye të cilat janë cekur më herët për të mos i përsëris. Gjithashtu kërkoj nga ky Kuvend të mbështet atë deklaratë dhe të merr emërtimin deklaratë e Kuvendit Komunal të Rahovecit e jo të jetë vetëm e KPF. Kërkoj nga përfaqësuesit politik që janë këtu në këtë Kuvend që të kërkojnë prej deputetëve të partive të tyre të përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës që të mos e përkrahin këtë draft Ligj kur të vie në diskutim në Kuvendin e Kosovës. Prandaj me këtë i kemi treguar shumë qartë që e kundërshtojmë këtë draft Ligj dhe i bëjmë me dije të gjitha institucioneve qendrore dhe institucioneve tjera ndërkombëtare që Komuna e Rahovecit nuk ka dëshirë që të vij në një pozitë në të cilën duhet të kundërshtoj edhe me mjete tjera.

Rexhe Oruçi – me vëmendje e kam lexuar këtë Projektligj për Hoçë të Madhe i cili sipas meje është Ligj problematik dhe të gjitha nenet e tij janë për t'u habitur edhe për hartuesin e Ligjit si dhe për të gjitha grupet punuese që kanë punuar në hartimin e tij sepse kanë bërë shkelje drastike të Kushtetutës, të LVL, të Statutit dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore. Projektligji parasheh një surrogat në mes të zonave të veçanta mbrojtëse që i kemi në Kosovë dhe të Komunës. Në këtë Projektligj fatkeqësisht është punuar një kohë të gjatë, ku kanë punuar grupet punuese të cilat janë edhe në administratë të Komunës, të cilët marrin paga. Është bërë një punë shumë e gjatë edhe me përfaqësues të Bashkësisë ndërkombëtare por edhe me përfaqësues të Qeverisë së Kosovës. Fatkeqësisht Ligji ka edhe disa dokumente tjera përcjellëse të cilat ne nuk i kemi këtu. Është bërë zona kadastrale, janë bërë kufijtë e Hoçës së Madhe dhe faktikisht është bërë përcaktimi territorial i këtij fshati ndërsa Ligji i parasheh kompetencat për Këshillin, këshillat mbikëqyrës, që është një gjendje e papranueshme, jo vetëm për neve si Asamble por edhe për të gjithë qytetarët e Kosovës por në fund të fundit do të jetë një Ligj i dëmshëm edhe për vetë minoritetin serb. Frikohem se pak jemi vonuar, është një reagim i cili ndoshta nuk mund të ketë efekt juridik sepse edhe nuk jemi shumë kompetent ngase përveç reagimit ne mundësitë tjera nuk kemi. Mirë është që grupi i veçantë në krye me Kryetarin e Komunës sikur që është propozuar së bashku me përfaqësuesin e secilit subjekt politik të reagojë sa më shpejt.

Rasim Fazliu – në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së e shpreh indinjatën për këtë Projektligj dhe e kundërshtojmë rreptësisht i cili Ligj nuk është në të mirën as të komunitetit serb që jetojnë në Hoçë të Madhe po as të Komunës së Rahovecit sepse ja cenon të drejtat e Komunës. Prandaj e mira do të ishte që minoriteti serb në Hoçë të Madhe ta gjej të drejtën e vet dhe të integrohet në Komunën e Rahovecit sepse vetëm ashtu do të ishte mirë dhe do të ishte drejtë. I bashkangjitem të gjitha mendimeve të kolegëve që diskutuan më parë.

Labinot Berisha – ky draft Ligj i draftuar nga MMPH tanimë siç duket është vetëm një iniciativë e dështuar në aspektin strategjik dhe politik për të ardhmen e kësaj Komune si shoqëri demokratike, ku toleranca ndër fetare ka qenë e mirë veçanërisht nga shumica shqiptare në këtë Komunë dhe kjo është dëshmuar gjithëherë, ndërsa nga Ministri i MMPH z.Dardan Gashi mirë do të ishte që ai të merret me parandalimin dhe mbrojtjen e shtratit të Drinit të Bardhë që pasojat janë të mëdha në florën dhe faunën dhe në tokat bujqësore përreth për rreth shtratit të Drinit në tërë rrjedhën e territorit administrativ të Komunës së Rahovecit se sa të merret me këtë draftim ku pasojat janë mjaftë të mëdha. Unë personalisht shpreh shqetësimin e thellë dhe kundërshtoj pa hamendje këtë draft Ligj i cili do të jetë mullë shërri për integrimin e mëtejshëm social, kulturor dhe institucional për të gjitha komunitetet e në veçanti atë serb. Përfundimisht vlerësoj që Kryetari i Komunës së Rahovecit dhe Kuvendi Komunal duhet të angazhohen seriozisht dhe të shprehin pakënaqësinë dhe kundërshtimin e fuqishëm përmes takimeve me Kryeministrin, Ministrin e MMPH, ICO, deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe me të gjitha organet kompetente që kundërshtimi ynë mos të jetë i formës deklarative, përndryshe mos të ndodh që qytetarët të shprehin shqetësimin e tyre për këtë Ligj, që do të cenohet seriozisht siguria në Komunën tonë.

Ilirjana Gashi – bëhet fjalë për një problematikë të madhe që po ndodh në Komunën e Rahovecit për shkak të padrejtësisë që po i bëhet këtyre institucioneve e po ashtu edhe qytetarëve të kësaj Komune për shkak të gjithë asaj që kanë kaluar këta qytetarë gjatë luftës e po ashtu edhe padrejtësitë pas luftës. Do të ishte e padrejtë të heshtim karshi një problemi të tillë dhe të mos shprehim indinjatën e po ashtu edhe shqetësimin tonë për këtë problematikë. Unë kam shpresë se nuk do të dalim para një akti të kryer dhe të hyjë në funksion ky Projektligj, mirëpo me të gjitha mundësitë dhe bazën juridike ligjore ky Projektligj të kundërshtohet dhe të mos miratohet në Kuvendin e Kosovës sepse pak a shumë do ti jep një kahje krejt tjetër Komunës së Rahovecit duke marr për bazë që aty po formohet një Këshill prej 7 vetave, 5 nga komuniteti serb, 1 nga kisha ortodokse dhe 1 nga Komuna e Rahovecit, që do të thotë se pjesëtari i Komunës së Rahovecit edhe nëse do të dojë të marr ndonjë iniciativë apo diçka ai nuk do të mund të realizoj asgjë. Unë shpresoj që këto deklarata dhe këto që u thanë këtu në këtë Kuvendi nuk do të has në veshë të shurdhër për shkak se do të ishte e padrejtë nga Qeveria e Kosovës që t'i bëhet një padrejtësi Komunës së Rahovecit me miratimin e këtij Projektligji për Hoçën e Madhe, sepse të gjithë e dimë që trashëgimia kulturore është e mbrojtur me Ligj dhe nuk do të ketë nevojë për një Projektligj tjetër.

Fane Thaçi – pajtohem plotësisht me parafolësit pasi që shumë mirë cekën dëmet që shkakton ky Projektligj dhe ftoj të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës që të ndërpritet ky Projektligj që në hapin e parë të cilin e kundërshtoj dhe kurrësi nuk pajtohem me të.

Elhami Zhuniqi - ky draft Ligj është në kundërshtim me të gjitha aktet më të larta të vendit, mirëpo i njëjti është në realitet një vendim politik dhe shumë i dëmshëm e në radhë të parë për vet qytetarët e fshatit Hoçë e Madhe sepse i njëjti pengon integrimin e qytetarëve të Hoçës në Komunën e Rahovecit, në realitet bënë edhe legalizimin e strukturave paralele që veprojnë në Hoçë dhe në shumicën e lokaliteteve serbe në Kosovë, kështu që ky diskriminim pozitiv që po tentohet t'i bëhet qytetarëve të Hoçës së Madhe do të prodhoj pasoja negative në kundërshtim me atë çfarë po flitet në draft Ligj që do të prodhojë pasoja pozitive, ky do të jetë në kundërshtim dhe do të prodhojë pasoja negative. Neve shqiptarëve gjithmonë gjatë historisë jemi trajtuar negativisht ndërsa tash po tentohet që një komunitet të trajtohet ndryshe, mirëpo vet diskriminimi qoftë edhe pozitiv do të prodhoj pasoja negative. Prandaj konsideroj se ky draft Ligj është i dëmshëm, duhet të ndërpritet menjëherë, të kundërmohet fuqishëm sepse është në kundërshtim me të gjitha aktet më të larta të vendit.

Esad Haxhijaha - pajtohem plotësisht me reagimet të cilat u thanë deri më tani sepse draft Ligji drejtpërdrejtë uzurpon të drejtat e organeve komunale, anashkalon institucionet e Komunës dhe ndërhyjnë në zgjidhjet të cilat thjeshtë janë të natyrës së ndjeshme dhe është plotësisht e arsyeshme që jo vetëm Komiteti për Politikë dhe Financa por edhe Asambleja komunale të reagoj dhe të mos pajtohet me një praktikë kësajsoj diskriminuese ndaj organeve komunale. Pajtohem edhe me atë ngase nuk është vonë të reagohet kështu siç ka propozuar Kryetari që me kryetarët e grupeve parlamentare dhe atë urgjentisht të shkohet të bisedohet me bartësit e përpilimit të këtij draft Ligji dhe të barten reagimet dhe mospajtimet e Asamblesë komunale me një zgjidhje kësajsoj, përndryshe është diskriminim i bashkësive tjera lokale. Nëse një bashkësi në këtë mënyrë, nëse mendon se është një formë e decentralizimit, bëhet një orientim kësajsoj kjo duhet të bëhet edhe për bashkësi tjera lokale. Kjo është ajo që është demokratike, që është barabarësi dhe në këtë duhet të kërkojmë prej Ministrisë e cila është bartëse e përpilimit të draftit.

Kryesuesi – mendim i juaj si delegatë të Asamblesë komunale të Rahovecit është edhe mendimi i qytetarëve të Komunës sepse vërtet një ligj i tillë është diskriminues për Komunën tonë dhe nuk mundem ne si Komunë të bëmë pre e orekseve të njerëzve të cilët konsiderojnë që me anë të kësaj të arrijnë qëllimet e tyre ndërsa në anën tjetër ne të bëmë pre e këtyre gjërave. Ne jemi mësuar me këso gjëra edhe në të kaluarën, e dimë që çdo herë na është ofruar një diçka që kinse ne nuk po humbim asgjë, mirëpo erdh momenti që faktikisht ne çdoherë kemi qenë viktimë e këtyre gjërave. Prandaj, konsideroj që ne si Kuvend i Komunës do t'i shfrytëzojmë të gjitha mekanizmat për të parandaluar këtë Projektligj, do të paraqesim edhe ankesë nëpër institucionet e Republikës së Kosovës, Parlamentin e Republikës së Kosovës, Qeverinë dhe të gjitha instancat. Nëse pajtoheni ne mund të dalim me një deklaratë nga Kuvendi Komunal.

Smajl Latifi – dëshiroj të falënderoj të gjithë këshilltarë të Kuvendit të Komunës për kontributin që e dhanë në favor të kundërshtimit të bazuar, në argumentet të fuqishme dhe në fakte konkrete për domosdoshmërinë e ndërprerjes sa më shpejtë të këtij Ligji. Unë kam pasur takime të shumta ku kemi debatuar për këtë Ligj dhe mund t'ju them që ka pasur një

presion të vazhdueshëm. Na është tërhequr vërejtja që të mos merremi shumë me këtë temë. E ndjej veten shumë mirë që tani përveç qytetarëve të Komunës, shoqërinë civile e kemi edhe një institucion të fuqishëm i cili bashkë me Kryetarin dhe qytetarët e Komunës do t'i adresoj seriozisht këto shqetësime që kemi ne dhe do ta kundërshtomë fuqishëm me të gjitha mjetet juridike këtë Projektligj në mënyrë që sa më shpejtë është e mundur të ndërprehet. Jam gati edhe njëherë që përveç këtij falënderimi bashkë me ju të shkojmë në çdo zyrë dhe t'i adresojmë qartazi, t'i përmbledhim këto diskutime, këto argumente dhe fakte që lidhen me kundërshtimin e këtij Projektligji bashkë me ju.

2. Njoftim mbi gjendjen e furnizimit me ujë të pijes në Komunën e Rahovecit.

Ismet Berisha, udhëheqës i Sektorit operativ të Rahovecit në Kompaninë Regjionale Hidroregjioni Gjakovë – me kërkesën e Juaj kam përgatitur një informim për të pasur ju një qasje më detale rreth furnizim me ujë në Rahovec si qytet dhe disa vendbanime. Kompania rajonale e ujësjellësit në Gjakovë menaxhon në vete Gjakovën me 40 fshatra, Rahovecin me 20 fshatra dhe disa fshatra të Komunës së Prizrenit ose rreth 200.000 banorë. Komuna e Rahovecit asiston në sistemin e ujit me rreth 50.000 banorë. Vështirësitë në furnizim me ujë zakonisht paraqiten në sezonin e verës dhe kjo është si rezultat i pasojave të shpenzimit enorm të shumëfishtë nga ana e konsumatorëve sidomos në viset rurale, viset e ulëta dhe ato zona ku ujin e marrin me gravitacion apo me ramje të lirë. Arsyet qëndrojnë në atë se uji zakonisht me presion është më i madh në viset e ulëta ku qytetarët me përjashtime të pandërgjegjshëm ujin e destinonjë për qëllimet e tjera si për ujitjen e kulturave bujqësore, të kopshteve, rrugëve, trotuareve, autolarje. Ne përkundër të gjitha këtyre të këqijve Kompania ka marr disa masa shtesë duke mobilizuar stafin e vetë në këtë drejtim që të kalojmë sa më lehtë këtë sezon të verës. E falënderojmë kryetarin i cili me organet e veta komunale si inspektorët dhe personalisht vetë është angazhuar në këtë drejtim me një qasje serioze që të tejkalohet kjo gjendje, duke marr për bazë seriozitetin dhe atë që është jetike për njeriun. Problemi në Rahovec sidomos mi theksuar është në zonën e dytë dhe të tretë. Ju të gjithë e dini se uji në Rahovec për dallim prej qendrave tjera merret me pompim do të thotë e shton koston e prodhimit dhe problematikat teknike shtohen sepse 70% i Rahovecit duke u nisur nga hyrja e Rahovecit nga “mulliri i Aliagës” deri te rruga “Vëllezërit Frashëri” e marrin ujin me zonën e parë me pompim, mirëpo zona e dytë dhe e tretë për shkak të lartësive të mëdha se akumulimi i rezervuarit “Qerim” është në 424 kuotën e lartësisë mbidetare ndërsa Rahoveci në hyrje të rezervuarit të parë është në 404, e dyta është në 506 dhe rezervuari i tretë që është i pamjaftueshëm është në kuotën 560 që do të thotë se me dy kaskada bëhet ngritja e ujit. Ne për t'i eliminuar të gjitha këto dallime kemi aplikuar edhe një restriksion apo reduktim të ujit në viset e ulëta në mënyrë që t'i ngrisim ujin edhe këtyre zonave. Problematikë na paraqesin disa keqpërdorues që manipulojnë jashtë autorizimeve me valvulet në Fortesë dhe Xërxe, linja që ndahet për Gexhe deri në Denjë dhe vija tjetër që ndahet për Lumbardh ajo pjesa që janë 7 fshatra të Komunës së Rahovecit dhe 13 fshatra të Prizrenit. Kapacitetet maksimale të “Radoniqit” janë 600 litra në sekondë ose mbi 2.000 m3 në orë. Presioni ka qenë që të implementohet edhe faza e dytë e “Radoniqit” që do të shtojë sasinë e prodhimit edhe për 600 litra në sekondë. Në zonën e tretë në Rahovec është një rezervuar i cili nuk i plotëson kapacitetet e konsumatorëve ku janë 330 sish, kurse kapaciteti i rezervuarit është 250. Pompat të cilat janë instaluar në vitet e kaluara janë mjaft të amortizuara dhe janë 16 kW dhe është problematike për të pasur furnizim edhe gjatë sezonit dimëror e lëre më verës sepse me këtë rezervuar është e pamundur të ketë furnizim 24 orë. Në Lug të bunarit ne i kemi ndarë linje pika 1 dhe 2 dhe në linje tonë vijnë 23.000 m3 për 24 orë dhe kur e ndajmë atë ujë neve na del se kemi ujë të mjaftueshëm. Nëse marrim një krahasim tani Krushën e Madhe, Fortesën ose Sopniqin përderisa në Rahovec kemi 2 m3 për konsumator që shpenzohen aty kemi 5 m3 dhe ne tani jemi të detyruar që të ndikojmë me punëtorë dhe me ndihmën e policisë dhe inspektorëve dhe jemi në aksion prej 20 qershorit dhe në mbremje i mbyllim ventilet në mënyrë që të akumulojmë ujin gjatë tërë natës për Rahovecin dhe në mëngjes të gjithë të keni nga pak ujë sepse deri sa mbërrin në Rahovec pa 5 ose 6 bar nuk bënë derdhjen në rezervuar. Lidhur me këtë rezervuar edhe Kompania por edhe Qeveria komunale do të shohim mundësitë financiare për zgjerimin e kapacitetit. Me një shfrytëzim më racional dhe për nevojat më të domosdoshme dhe vetëdijesim të qytetarëve besoj që do të tejkalojmë këtë mungesë dhe ju të apeloni tek qytetarët dhe gjithë konsumatorët që ujin të mos e keqpërdorin.

Rexhep Oruçi – në mbledhjen e kaluar parashtrova këtë çështje për shkak të preokupimit të qytetarëve por tani po del që jo vetëm qyteti i Rahovecit por problemi po paraqitet edhe në disa fshatra të Komunës, mirëpo unë po flas për Zonën e II-të në Rahovec ndërsa zona e III-të dihet që nuk ka ujë. Zona e dytë nuk ka ujë prej 1 shkurt gjithë që ne që jetojmë në këtë zonë nuk kemi ujë as gjatë sezonit të dimrit. Tani dy javë e këndeje është një përmirësim dhe nëse në qershor dhe korrik kemi ujë atëherë është e pamundur që në shkurt dhe mars të mos ketë furnizim me ujë dhe mendoj që këtu është faktori njëri, prandaj me një angazhim më të madh nga Kompania e juaj do të kishim edhe në këtë zonë ujë dhe qytetarët do të ishin të kënaqur.

Ismet Berisha – përpos defekteve teknike neve na kufizon edhe energjia elektrike sepse na paguajmë rreth 10.000 € në muaj, por pa dallim kësaj reduktimet e rrymës janë më të theksuara gjatë sezonit të dimrit dhe kjo ndikon shumë në furnizim me ujë. Faktor dhe komponentë kryesor në ujë dhe rrymë është faturimi dhe inkasimi i borxhit dhe ne si territor administrativ i Rahovecit sipas shënimeve kemi mbi 1.700.000 € borxh për ujë.

Xhihad Vuçitërna – nëse ishin ndërprerë keqpërdorimet që janë nëpër fshatra ku kalon gypi deri në qytet gjatë sezonit të verës, a do të kishte pasur qyteti ujë të mjaftueshëm?

Ismet Berisha – nëse arrijmë ne t'i ndërpresim të gjitha keqpërdorimet në zonat rurale dhe në Rahovec dhe uji të dedikohet vetëm për qëllimet e caktuara ju garantoj me plotë përgjegjësi se Rahoveci do të kishte ujë 24 orë.

Xhihad Vuçitërna – i drejtohem kryetarit dhe këshilltarëve që të marrin këtë problem më seriozisht që këto keqpërdorimet të ndërpriten dhe në Rahovec të ketë ujë të pijshëm edhe gjatë sezonit të verës.

Ismet Berisha – “Radoniqi” është njëri prej liqeneve që ka mbi 115 milion m³ ndërsa ne me Gjakovën mesatarisht shpenzojmë 1.500 m³ në muaj që do të thotë se edhe 2-3 vjet mos të ketë reshje fare ka ujë, mirëpo duhet të zhvillohen politikat e drejta.

Feim Fetoshi – informatat e dhëna nga drejtori janë shumë koncize sepse ne kemi menduar që në projekt kur është bërë ka pasur gabime dhe nuk ka shanë që Rahoveci të ketë ujë. Ju e thatë shumë qartë që nëse ndalen keqpërdorimet garantoni që Rahoveci të ketë ujë 24 orë dhe informatë më të mirë në Kuvend akoma nuk kam dëgjuar. Ju përmendet ndërtimin e fazës së dytë dhe unë nuk shoh kurrfarë arsye pse të filloj faza e dytë kur me ndaljen e keqpërdorimeve po zgjidhet gjithçka, atëherë faji qenka te shteti dhe te menaxhmenti i Ndërmarrjes “Radoniqi”. Keqpërdorues ka pasur, ka dhe do të ketë gjithmonë, jo vetëm në Kosovë por në tërë botë, ndërsa shteti është ai i cili duhet t’i ndaloj dhe stopoj keqpërdoruesit. Ne si këshilltar komunal, qoftë si struktura politike në të gjitha aspekte që do të na quani natyrisht që duhet dhe do t’ju mbështesim, por ju duhet të krijoni projekte dhe forma që të ndalni keqpërdorimet. Është policia për t’ju mbrojtur, janë organet nga të gjitha institucionet shtetërore në Kosovë që funksionon dhe e dimë që policia është hallka që më së miri funksionon. Problematika qenka te hallka e bashkëpunimit në mes të ndërmarrjes suaj dhe shtetit, prandaj apeloj te ju që t’i përcillni brengat tona te menaxhmenti i “Radoniqit” dhe të gjitha organet dhe hallkat e pushtetit që urgjentisht të ndërmarrin masa sepse nga kjo që e thatë ky problem qenka i zgjidhur dhe duhet të zgjidhet.

Rrustem Thaçi – në komunë tonë është bërë hapja e rrjetit të ujit të ujitjes në drejtim të Potoqanit dhe të Sopniqit dhe a ka ndikuar pozitivisht kjo në ngritjen me furnizim të ujit të pijes të qytetit Rahovec?

Ismet Berisha – përfshirja në sistem të ujitjes normal që i iket keqpërdorimit të ujit të pijes mirëpo ajo nuk bëhet menjëherë sepse sistemet që i kanë instaluar për ujë të pijes për fat të keq përdoren edhe për ujitje dhe është shumë herët të vërehet efekti. Ne kemi konsumatorë të cilët janë ankuar se keni ujë të kontaminuar dhe gjatë inspektimit është konstatuar se ka lidhë gypin e ujit të ujitjes me gypin e ujit të pijes.

Lumturije Hoti – a ka mundësi që të informohen qytetarët me orarin e reduktimeve?

Ismet Berisha – ne më 20 qershor i kemi shpërndarë apelet, njoftimet rreth reduktimit nëpërmjet Radio “Start” prej 27-30 qershor vazhdimisht ka njoftuar e po ashtu edhe përmes inkasantëve janë shpërndarë vendimet për kufizimet e ujit. Për Krushe të Madhe linja në Fortesë ndalet në ora 8 në mëbrëmje ndërsa lëshohet në ora 8 të mëngjesit. I njëjti orar është edhe për vijën Gexhe – Ratkoc.

Avdullah Kryeziu – me një takim publik të datës 17 qershor kryetari është takuar me përfaqësuesin e Kompanisë të ujit të pijes në Rahovec në të cilin ka qenë edhe Berisha dhe personat tjerë në të cilin takim është thënë që ka munguar komunikimi ndërmjet institucioneve komunale dhe Qeverisë. Në këtë drejtim është thënë se ka mungesë të pajisjeve e që normal se i kuptojmë vështirësitë e kësaj Kompanie për mirëmbajtjen dhe evitimin e prishjeve, po ashtu ka shumë humbje të ujit të cilat i përmendi Berisha, por çështja problematike është te faturimi ku faturohen rreth 50 mijë m³ ujë.

Normalisht duke marr parasysh të gjitha këto vështirësi, unë e di që në qeverisjen e mëhershme ka pasur një urdhëresë nga organet e atëhershme mirëpo tani me LVL pavarësisht që kjo Kompani është e mbikëqyrur më së tepërmi nga niveli qendror, por kur janë në pyetje qytetarët e Komunës së Rahovecit kryetari i Komunës ka përgjegjësi shtesë në këtë drejtim dhe më vjen mirë që keni bashkëpunim të mirë në mes të Kompanisë rajonale të ujit të pijes dhe Kuvendit Komunal të Rahovecit. Ekziston rregullatori për ujë dhe mbeturina në kuadër e të cilit ka edhe rregullore që sanksionojnë keqpërdoruesit e ujit, por pavarësisht kësaj, kryetari i Komunës në bazë të LVL është i obliguar që të nxjerr një urdhëresë për përdorimin e ujit të pijes në Komunën e Rahovecit sepse nëse nuk ka një rregullore të tillë për mënyrën e rregullimit dhe kufizimit të përdorimit të ujit për pije nga rrjeti i ujësjellësit të “Radoniqit” atëherë nuk e di se si do të ndëshkohen qytetarët ose keqpërdoruesit që bëjnë keqpërdorime të ujit të pijes në Komunën e Rahovecit. Duhet të shpallet një gjendje emergjente në Komunën e Rahovecit në kohën prej 1 qershor deri më 15 tetor ku është shfrytëzimi më i madh i ujit të pijes dhe të ndalohet shfrytëzimi i ujit të pijes nga rrjeti i ujësjellësit për larjen e automjeteve, rrugëve, trotuareve, vendeve publike, ujitjen e kopshteve, fusha me bar, pemëve dhe ndonjë fushë të agrikulturës. Nëse nuk e keni bërë këtë rregullore z.kryetar ju kisha preferuar që të bëni këtë sepse nuk ka në bazë të çkahit të punoj inspekcioni komunal nëse nuk ekziston një rregullore e tillë dhe nuk e di se si do të sanksionohen qytetarët e pandërgjegjshëm të cilën e keqpërdorin ujin e pijes nëse nuk ekziston një urdhëresë e tillë.

Sinan Ejupi – dëgjuam shkaqet kryesore nga drejtori të cilat nuk janë shumë të rënda për zgjidhjen e problematikës së ujit, por e pyes kryetarin e Komunës se a ka fuqi ligjore dhe sa do të jeni rezistent në dhënien e kompetencave respektivisht në përkrahjen për ndalimin e keqpërdorimit të ujit dhe të merreni shumë seriozisht këtë punë.

Xhemali Haxhimustafa – ky problem nuk mund të zgjidhet edhe shumë kohë deri sa mos përputhen interesat lokale dhe të Qeverisë qendrore sepse vetë Kompania rajonale e ujërave “Radniqi” është në ingerenca të Qeverisë së Kosovës. Ju të gjithë e dini se në Komunën tonë kemi gypa të azbestit që janë të vitit 1962 të cilat janë kancerogjene, të cilat në emër të riparimit të tyre janë marr disa mjete, por sido që të jetë edhe kjo është pjesë e kësaj të cilat drejtori nuk ka faj këtu. Jam shumë i bindur se mbi 35% të ujit ka humbje në rrjet. Rahovecit me Hoçë të Madhe dhe Brestoc i duhen 6.200 m³ ujë që të furnizohet për 24 orë për të pasur mesataren e shfrytëzimit të ujit që ka një qytetar i Kosovës. Në qoftë se çdo konsumatori vetëm për mirëmbajtje i futet në faturë 1 € ndërsa 0,50 centi është për mirëmbajtje të kanalizimit automatikisht në faturën e shfrytëzimit janë edhe 1,50 € të cilat paguhet për mirëmbajtje dhe për kanalizim.

Fane Thaçi – pyes drejtorin për 5 fshatra që priten se do të kyçen në ujësjellësin e “Radoniqit” a do të kenë ujë të mjaftueshëm apo edhe ne do të ballafaqohemi me vështirësi si qyteti i Rahovecit.

Ismet Berisha – me siguri kryetari do t'ju informoj më tepër sepse e ka ngritë këtë çështje te menaxheri kryesor Albert Zajmi para dhjetë ditësh, por është shumë problematike me ju thënë se ju do të keni ujë të mjaftueshëm dhe nuk do të keni krizë sepse pa funksionimin e tri hallkave qoftë për kanalizim, për ujë apo për rrymë, Komunitet-Komunë-Kompani dhe këtu zgjidhet problemi. Tek ju ende është problematikë kycja-lidhja.

Rukije Krasniqi – meqenëse është problemi faktori njeri atëherë edhe faktori njeri mund t'i evitoj këto defekte. Ne si këshilltar nëpër vendet nga vijmë mund të organizojmë takime dhe t'i informojmë qytetarët, me mbajt takime informuese rreth mbrojtjes së ambientit dhe mirëmbajtjes dhe ruajtjes së ujit dhe t'i njoftojmë qytetarët ngase ata nuk janë të njoftuar. Meqë po bëhet informimi edhe nëpërmjet radios lokale që sa më tepër të bëhet jo vetëm vetëdijesimi por edhe ngritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve sepse është mungesë e ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe dikush të mos ketë ujë me pi e dikush tjetër të ujit kopshtet kjo është shumë e padrejtë, kjo është shkelje e së drejtës parimore e drejtës së njeriut në radhë të parë.

Ilirjana Gashi – nëpunësit e ujësjellësit të “Radoniqit” të cilët punojnë, thuhet që ka keqpërdorime prej banorëve, mirëpo ka keqpërdorime edhe të nëpunësve të juaj ngase na vijnë fatura në kohën kur ka të reshura kanë ardhur fatura prej 75 € për një muaj për familje 3 anëtarësh që është jashtë logjikës të bëhen këto shpenzime për një muaj duke mos e kontrolluar njehsorin fare.

Ismet Berisha – sa i përket sensibilizimit na veç jemi në fushatë së bashku me inspektorë dhe besoj se do të jep rezultate. Sa i përket keqpërdorimit të punëtorëve duhet të dimë se ekzistojnë rregulloret e brendshme. Ne e dimë që 90% i kemi të instaluar ujëmatës te konsumatorë, mirëpo nuk e përjashtojmë mundësinë se ujëmatësi ndalet për shkak të punimeve tona dhe punimeve të paautorizuara të ekipeve të jashtme, kështu që aty ku nuk funksionon ora sistemi i pronetit veç sa të shkruhet “P” në mënyrë paushall shkruhen 70 m3 pa të drejtë, mirëpo me qëllim të vetëdijesimit të konsumatorit se vetëm përmes matësit duhet bërë matje.

Nahit Elshani - kam pyetje e cila ka të bëjë me ish sistemin e ujit të pijes në Babindol. Ne kur kemi qenë në fillim të mandatit e dimë që kemi nënshkruar marrëveshjen për një shumë të konsiderueshme të mjeteve me qindra mija DM që janë financuar për atë ujë të pijes dhe a mund të funksionalizohet ai sistem dhe të jetë në veprim në mënyrë që në kohën e shpenzimit të madh të ujit të pijes të jetë si një sistem ndihmës për qytetin e Rahovecit.

Ismet Berisha – për këtë nuk kisha mundur me dhënë përgjigje adekuate sepse marrja në menaxhim dhe fuzionimit të pjesës së ujit të pijes është bërë në vitin 2002 me operatorin Gaservaser dhe për shkak të ndotjes së ujit ka mbetur jashtë sistemit.

Smajl Latifi – unë si kryetar i Komunës së Rahovecit po bëjë përpjekje për ndryshimin e Ligjit mbi ndërmarrjet publike dhe shpresoj se ne do kemi sukses në mënyrë që Kuvendi komunal përkatësisht Qeveria komunale t'i merr disa përgjegjësi të cilat janë të munguara nga 2006 ose 2007 dhe të merr pjesë aktive në bërjen e politikave për ujin e pijes por edhe për ujin për ujitje. Beteja tjetër është me keqpërdoruesit, me borxhlinjtë të Komunës, që nuk janë të paktë në Komunën tonë. Për të fituar betejën me “Radoniqin” kem nxjerr vendimin për mos keqpërdorimin e ujit të pijes dhe jemi në aksion ku marrin pjesë inspektorati komunal, Policia e Kosovës dhe përfaqësues të KRU “Radoniqi”. Nuk na ka mjaftuar kjo, ne po përpiqemi ta sensibilizojmë dhe Kuvendi i Komunës së Rahovecit dhe këshilltarët e tij, që të kemi më shumë ujë të pijes duhet të marrim përsipër që t'i kryejmë obligimet dhe detyrimet tona për shkak se do të kemi më të lehtë fitoren e betejës me “Radoniqin”. Në seancën e kaluar të KPF nuk kam marr pjesë sepse kam qenë së bashku me Ismet Berishën, drejtorin gjeneral të “Radoniqit” Albert Zajmin dhe drejtorin teknik Hysni Çanta dhe ne jemi shumë të interesuar që t'i tregojmë për disa obligime të cilat nuk i kryen në raport me qytetarët e Komunës së Rahovecit, mirëpo besoni që nuk kemi kaluar shumë mirë edhe pse biseda ka qenë shumë konstruktive. Unë shpresoj që takimet tona dhe komunikimi jonë do të jetë shumë normal dhe do të jemi shumë serioz në përkushtimet tona që të ofrojmë zgjidhje më të mirë në furnizim me ujë të qytetarëve të Komunës së Rahovecit. Ata pohojnë se kemi rreth 2 milion Euro borxh, janë me qindra keqpërdorues të ujit të pijes të cilët në mënyrat e ndryshme e pamundësojnë furnizimin më të mirë të Komunës tonë, të vendbanimeve e në rastin konkret edhe të pjesës së epërme të qytetit të Rahovecit.. Nuk është bërë pranimi teknik as në Potoqan të Ulët e as në Potoqan të Epërm e as në Nashpallë. Përfaqësuesit e këtyre vendbanimeve kanë nënshkruar një dokument ku kanë marr përsipër që komuniteti me i mirëmbajtur pompën dhe ujësjellësin. Ne po përpiqemi që t'i bëjmë me dije Gjykatës komunale dhe asaj për kundërvajtje që t'i kryejnë obligimet e veta sepse secili e ka për detyrë në bazë të përgjegjësisë dhe detyrimeve të ligjit që kanë t'i kryejnë si duhet. Në qoftë se do të kemi mundësi me aksionin sistematik në luftë kundër keqpërdoruesve të ujit, që është aksion gjithëpërfshirës ndërmjet institucioneve të caktuara dhe prodhohet rezultate konkrete, ju garantoj që me drejtorin gjeneral të “Radoniqit” kemi me përfituar furnizim shumë më të mirë me ujë të pijes në qytetin dhe Komunën e Rahovecit. Kuvendi i Komunës së Rahovecit ka dalë me deklaratë si vijon:

Mungesa e ujit të pijshëm në shumë vendbanime të Komunës së Rahovecit, ka shkaktuar shqetësime të mëdha tek banorët e kësaj komune, prandaj Kuvendi Komunal i Rahovecit ju bën thirrje qytetarëve që të kenë kujdes në shpenzimin e ujit të pijshëm.

Keqpërdorimet e mëdha të ujit të pijshëm për ujitje, larjet e rrugëve e trotuareve, lidhjet ilegale në rrjet dhe përdorimi i ujit të pijshëm për qëllime të tjera, ndikon në mungesën e madhe të ujit. Prandaj veprimi i përbashkët i të gjitha strukturave komunale, KRU Radoniqi dhe Policisë së Kosovës dhe qytetarëve mund të ndikoj në përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm të konsumatorëve. Njëkohësisht kërkojmë edhe nga organet e drejtësisë në Gjykatën komunale dhe gjykatën për kundërvajtje, që të bashkëpunoj suksesshëm me strukturat komunale për evitimin e këtyre

keqpërdorimeve. Për të evituar marrjen e masave ligjore ndëshkimore, kërkojmë nga të gjithë qytetarë që të përdorin me kursim ujin e pijshëm dhe ta përdorin atë ekskluzivisht për nevojat themelore për të cilat është i dedikuar uji nga KRU Radoniqi.

3. Shqyrtimi i Pasqyrës financiare dhe Raportit të Auditorit të Pavarur (të përgjithshëm) për vitin 2010.

Avdullah Kryeziu – raporti i auditorëve të pavarur për Komunën e Rahovecit deri më 31.12.2010 ka të bëjë me ish Qeverinë, mirëpo pavarësisht kësaj është mirë që disa lëshime që janë bërë të mos përsëriten në këtë Qeveri, është mirë që të përmirësohet ky raport dhe Komuna e Rahovecit të tejkalon këtë fazë të lëshimeve që janë bërë. Krahësuar raportet e vitit 2008, 2009 dhe 2010 përsëriten gjërat e njëjta, pasqyrat financiare janë jo të rregullta, menaxhimi i pronave dhe të pajisjeve situata është e njëjtë për këto 3 vite, nuk respektohet UA 21/2009 lidhur me menaxhimin e pasurisë dhe nuk futen të dhënat në sistemin informativ të menaxhimit financiar në Kosovë free blance, është problem kontabiliteti i brendshëm. Në faqen 7 të përgjithshme thuhet se është emëruar për të ushtruar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës Shtimje. Përgjigja e menaxhmentit në të gjitha këto të gjetura të auditorit ka qenë që do të përmirësohet, mirëpo asgjë nuk është përmirësuar, kjo është e keqe e përgjithshme sepse nëse thuhet se do të përmirësohen gjëra në rekomandimet e auditorit atëherë nuk është bërë asgjë në këtë drejtim. Po ashtu edhe të shpenzimet ka keqpërdorime në Drejtorinë e shëndetësisë, në arsim, përmendet Budva 2010 dhe ju keni vazhduar edhe në vitin 2011. Ka edhe të gjetura tjera që korrespondojnë me të gjeturat e Raportit të auditorit të brendshëm të Komunës së Rahovecit. Te auditimi i brendshëm kam kërkuar që të formohet Komiteti i auditimit dhe nëse nuk formohet ky Komitet, gjëra të njëjta do të përsëriten. Po ashtu përmenden edhe keqpërdorimet në shtruarjen e rrugëve me zhavorr, të cilat janë bërë në fushatën zgjedhore dhe normalisht kanë dalë si të dhëna që korrespondojnë me keqpërdorime në Komunën e Rahovecit.

Përmenden shërbimet e famshme konsulente dhe të cilat vërtetë edhe auditori i brendshëm ka pasur vërejtje dhe ka vërejtje të mjaftueshme në shërbime konsulente të Komunës. Këto keqpërdorime të shumta në Komunë tonë të varfër janë një sinjal i keq sepse është në pyetje keqpërdorimi i parasë publike. Ka qenë një sinjal i mirë pak i mëhershëm në QMF ku janë marr disa persona në përgjegjësi dhe mendoj që kjo luftë kundër korrupsionit nuk do të ndalet, mirëpo është shqetësuese se në mënyrë të tërthortë po ndikohen institucionet e pavarura, policia, hetuesia, prokuroria dhe gjyqësia, të cilat janë shtylla kryesore të demokracisë në Kosovë. Kur janë në pyetje keqpërdorimet nuk bënë të përdoren standardet të dyfishta dhe shpresoj që në Komunën e Rahovecit gjyqësia dhe prokuroria do të vazhdojnë me hetime për keqpërdorime që janë bërë dhe normalisht aktorët të cilët kanë bërë këto keqpërdorime në fund do të japin përgjegjësi.

Nahit Elshani – raportet e auditorit të cilat po i shqyrtojmë kanë të bëjnë me ish Qeverinë komunale, mirëpo ky është një mësim edhe për Qeverinë e tanishme që të gjitha këto të gjetura, të gjitha këto shkelje të LPP si dhe të procedurave, po ashtu edhe të keqpërdorimeve të cilat janë bërë t'i eliminoj e sidomos rekomandimet të cilat i ka dhënë auditori gjeneral është mirë që të shikohen me kujdes nga Qeveria komunale në mënyrë që këto të eliminohen, këtë e them për faktin se qysh nga raporti i vitit 2008, 2009 po edhe për vitin 2010 i kemi po thuaj të njëjta të gjetura, të njëjta shkelje të ligjit, të njëjta shkelje të procedurave të prokurimit publik si dhe të keqpërdorimeve tjera të buxhetit të Komunës. Ajo që është shqetësuese për mua në këtë raport që nuk ka qenë në raporte tjera kemi të bëjmë me një raport të auditorit gjeneral i cili nuk ka asnjë koment të menaxhmentit, do të thotë menaxhmenti në momentin që nuk jep komente, pajtohet me raportin e të pajtohesh me një raport të tillë të auditorit i cili në asnjë pasus nuk sheh diçka të mirë pos komplet i tëri në të gjitha pasuset ka të gjetura ku kemi të bëjmë me shkeljen e LPP, procedurave dhe keqpërdorim të parasë publike. Disa të gjetura këtu që janë për të janë duke u përgjigj ish zyrtarë komunal ku thuhet se në Departamentin e shëndetësisë janë bërë rritje në pozita pa pasur kualifikime dhe dëshmi për aprovime të tilla. Kjo është një rekomandim për Qeverinë e tashme që mos t'i përsërit këto gabime dhe të bëjë avancime të shërbyesve civil në pozita të caktuara pa kualifikime përkatëse. Ju në Zyrën e prokurimit publik keni caktuar një njeri si përgjegjës i cili absolutisht nuk ka trajnim, nuk ka certifikatë që i lejon që ai të përzihet në Zyrën e prokurimit publik në Rahovec. Në vitin 2012 në Raportin e auditorit gjeneral do të keni të metë. Te auditimi i brendshëm thotë që kjo është përsëritur veç 3 vite, që komuna duhet të ketë një Komitet të auditimit, nuk është bërë edhe pse tash prapë jemi duke u vonuar sepse veç 6 muaj keni marr detyrën e kryetarit të Komunës dhe ka qenë dashtë të shikoni mundësinë e formimit të këtij Komiteti të auditimit i cili thotë në rast të mos miratimit ka rrezik të mos zbatimit të planit të auditimit edhe pse ne vazhdimisht kemi kërkuar edhe nga Qeveria e kaluar që ne si delegatë të Kuvendit komunal respektivisht si KPF që është e rregulluar edhe me LVL Njësia e auditimit të brendshëm t'i paraqet Raport të punës Komitetit për aprovim dhe në bazë të atij plani ne mund të përcjellim edhe punën e auditorit të brendshëm. Një rast që është të shpenzimet thotë gjatë testimeve tona të shpenzimeve në Departamentin e KRS, shpenzimet për promovimin e stadiumit të qytetit nuk u dha kontrata për fatura përkatëse nr. 4909 në një shumë prej 930 € dhe 3.445 €, do të thotë që kemi pasur drejtor në ish Qeverinë komunale që nuk i ka dhënë faturat auditorit të jashtëm dhe si ka mundur kjo të ndodhë që drejtori të mos komunikoj me auditorin e jashtëm. Në fund thotë se në dy dosje të tenderit kemi gjetur dy fatura të pranuar nga kontraktori me të njëjtin numër dhe nga kjo shihet se ka pasur keqpërdorim të madh. Në këtë raport shihen shkeljet të LPP, Ligjit mbi financat komunale dhe ajo që është më e keqe kemi të bëjmë me keqpërdorime të parasë publike të buxhetit komunal, por fatkeqësisht këto raporte nuk shkojnë në duart e prokurorit publik sepse ka mjaft material për ndjekje penale të njerëzve të cilët kanë keqpërdor me paranë publike. Pozicioni i konsulencës kërkohet të kihet kujdes aty sepse aty më së shumti është vjedhur paraja dhe ky pozicion duhet të hiqet prej buxhetit komunal.

Smajl Latifi – ne e kemi lexuar me vëmendje këtë Raport dhe rekomandimet të cilat janë dhënë, u janë dërguar të gjithë drejtorëve të drejtorive, ne po synojmë që maksimalisht të kontribuojmë që të mos përsëriten gjërat të cilat janë

evidentuar si jo të mira në fushën e qeverisjes në Komunën e Rahovecit. Do të formojmë edhe Komitetin e auditimit i cili do të kontribuojë shumë në mbarëvajtjen e asaj çka është e evidentuar në raportin e auditorit të jashtëm apo edhe në raportin e auditimit të brendshëm. Njësia e auditimit të brendshëm ka një strategji, ka një Plan vjetor të veprimit dhe auditon të gjitha resorët dhe ne mund të pajtohemi apo të mos pajtohemi me atë plan, mund të ndërhyjmë në kuptimin e vendosjes së prioriteteve, mund të aplikojmë auditim ad-hoc për diçka që llogarisim me interes që të auditohet, përndryshe strategjia e auditimit të brendshëm bëhet në bazë të Ligjit. Zyra e Prokurimit për tani ka ushtrues të detyrës së shefit të prokurimit e që është Kujtim Popaj, po ashtu Zyra e prokurimit ka edhe 2 zyrtarë të prokurimit të cilët nuk kanë të drejtë të nënshkruajnë kontratë apo çfarëdo dokumenti tjetër, por vetëm mund të ndihmojnë Zyrën e prokurimit. Te rekomandimet besoj që ne do të ishim shumë të gatshëm që ato t'i përfillim, me i dhënë komentet tona dhe të punojmë maksimalisht që të mos përsëriten ato që kanë mundur të konstatohen si të gjetura që kanë qenë të padobishme ose të dëmshme për interesat e qytetarëve të komunës, qoftë në kuptimin e keqpërdorimit të financave publike apo shpërdorimit të detyrës zyrtare etj. Ne jemi gati që të punojmë, por asnjë kontabilist serioz në kuptimin profesional nuk ka Komuna jonë prandaj janë paraqitë vështirësitë. Ne nuk mund të hapim vend të ri të punës, ata që i kemi nuk mund t'i përdorin sistemet dhe për këtë paraqiten problemet e njëjta në vitin 2008, 2009 dhe 2010. Nuk mund të themi që kemi një komision profesional ose ekspert të mirë në fushën e evidentimit, regjistrimit, mirëvajtjes së aseteve e as të pronës. Është një situatë që do reformë por të mos harrojmë disa kufizime të cilat neve nuk na mundësojnë për të marrë njerëz profesionist që mund të njohin mirë kontabilitetin apo mund të jenë në përputhje me trendët e zhvillimit bashkëkohor, prandaj për këtë pikë kisha marrë përsipër me mbrojtur të gjitha qeveritë e deritanishme për shkak se kanë pasur mungesë kuadri.

Nahit Elshani – është e qartë nëse e shikoni LVL neni 52 te detyrat dhe përgjegjësitë e KPF thuhet që auditori i brendshëm duhet të ofrojë Planin vjetor të punës për auditim të brendshëm. Ne nuk ndërhyjmë në Planin e punës së tij, por ne duhet të jemi të informuar me planin e punës që ai e ka bërë në fillim të vitit, ashtu siç duhet të jemi të informuar me Planin e punës që e bënë Zyra e prokurimit. Ju si kryetar i Komunës keni lehtësi nëse auditori i brendshëm ju informon për të gjeturat dhe për rrjedhat e parasë publike dhe keqpërdorimet tjera në kohë të caktuar. Nëse juve ju informon një vit prapa siç ju informon auditori i jashtëm, atëherë nuk e di çfarë vlere ka auditori i brendshëm. Sa i përket Zyrës së prokurimit ju keni caktuar një njeri jo profesionist në baza partiake ndërsa keni pasur ekonomistë dhe juristë të cilën keni mundur të caktoni në këtë zyre.

Smajl Latifi – nuk dëshiroj të kontestoj profesionalizimin ose jo profesionalizmin e dikujt, aty ka ndodh një transfer për shkak të vëllimit të madh të punëve që ka në Zyrën e prokurimit.

Xhemali Haxhimustafa – raportet e auditimit cilat përsëriten prej vitit 2005 e këndeje me disa lëshime tjera, përndryshe 70% e të gjeturave që shihen këtu janë ato që janë përsëritur edhe në vitin 2004-2008, por nuk isha pajtuar me kryetarin që tha se nuk kemi mundësinë e ndërrimit por kemi mundësinë e trajnimit, por unë kisha thënë se ai që nuk di le të shkojë në shtëpi e të vijë ai që din të punoj. Në anën tjetër këtu ka gjëra të cilat njerëzit i kanë dhënë vetes të drejtë të bëjnë shkelje procedurale kinse për të kryer punë më herët apo më vonë dhe plotësisht pajtohem me ato që u thanë këtu, por jo edhe në masë të madhe që të politizohen dhe në fund të fundit ne vetëm që po e diskutojmë përndryshe dikush tjetër është autoritativ për marrjen e masave ndaj shkeljeve ashtu siç janë. Sa i përket Komitetit për auditim kjo është mirë për Qeverinë komunale dhe për kryetarin për të pasur auditimin dhe zyrtari i auditimit përgjigjet më ndryshe kur ka Komitet i cili ka të drejtë t'i referoj kryetarit vazhdimin apo mos vazhdimin e kontratës për punë.

Salih Hoti – për sa i përket kësaj pike të rendit të ditës pajtohem me parafolësit që jemi bërë monoton në dhënien e mendimeve tona rreth çështjeve të auditimit dhe lirisht mund të them se me pak ndryshime i njëjti raport është i gjitha periudhave 2006-2010. Të njëjtat rekomandimet si janë dhënë si në vitin e parë kur kanë filluar raportet e auditimit deri në ditën e fundit. Unë këtë raport e kisha ndarë në dy pjesë, pjesa e parë ka të bëjë me respektim të procedurave administrative përfshirë për çështje të ndryshme. Pjesa e dytë ka të bëjë me aspektin e shpalljes së pasqyrave financiare për vitin 2010 dhe pjesa e tretë ndahet në të gjeturat të cilat i ka konstatuar auditori i pavarur Grant Norton. Tani është një bazë e mirë për të thënë të vërtetën nga të gjithë këtu, për shkak se realisht ne e dimë të vërtetën që Komuna e Rahovecit çalon në aspektin e kuadrit profesional që e bënë përgatitjen e pasqyrave financiare, por ne duhet të jemi më objektiv dhe nëse merren masa që këtyre kuadrove me i dhënë vërejtje me shkrim që për një periudhë tremujore të fillojnë me stabilizimin e gjendjes dhe nëse ata nuk janë në gjendje në këtë periudhë të fillojnë procesin e stabilizimit të punëve dhe detyrave të veta që i kanë, atëherë të ndërmerren masat tjera. Jam i bindur që nëse merren masat tjera, ndërrimi i vendit të punës, nuk kisha pasur dëshirë që të ketë reagime prej këshilltarëve dhe të thuhet se janë larguar në baza partiake, ashtu si nuk kam dëshirë që të njëjta lëshime, përgjegjësi dhe të njëjta gabime të ndodhin edhe në vitin 2011. Nëse të njëjtat persona lejohen dhe nuk merren masat që ata të vazhdojnë punën e vet si e kanë kryer deri më tani, ju garantoj se jo 70% por 100% kanë me u përsëritë të njëjtat gabime. Por, kuadër të mirë, njohës të mirë, kontabilist të mirë, nuk mundesh me marrë me 200-300 € pagë mujore dhe të punoj si duhet dhe për të mos pasur vërejtje nga auditori. Këtë anë të mosdijes duhet ndarë pak anash me tendencën për keqpërdorime, me tendencën për keqpërdorime të ndryshme qoftë materiale apo financiare. Nëse ne e bëjmë këtë prerje, këtë vijë të jeni të bindur që kemi me qenë shumëfish më objektiv se sa të mbetemi vetëm si kritikues dhe asgjë më tepër. Mos shprehja e auditorit të përgjithshëm është një defekt shumë i madh. Pse auditori nuk e ka dhënë opinionin e vet, konsideroj që këta ose nuk kanë ditur me i shpallur këto gjëra ose nuk kanë dashtë. Nuk është bërë dakordimi i të hyrave financiare, nuk është bërë harmonizimi në mes të departamenteve dhe personit që është përgjegjës për harmonizim të hyrave, nuk janë bërë llogaritë e veçanta për debitorët e Komunës. Krejt

këto janë pasojë ose e mosnjohjes profesionale ose një tendencë që qëllimisht me dhënë një gjendje të shtrembër dhe pse menaxhmenti i Komunës nuk ka ndërmarr asnjë masë që për kaq vite lëshime të paktën mos me pas shenjat e lëvizjes pozitive. Nëse ka shkelje që duhet dikush me u përgjigj penalisht, është një defekt prej nivelit më të lartë deri në nivelin më të ulët. Ky raport i auditorit duhet të shkojë edhe në Ministrinë e financave. I sugjeroj kryetarit të Komunës bashkë me Qeverinë komunale që këtë raport të auditimit, të gjitha rekomandimet që i ka dhënë auditori me i nda konform drejtorive përkatëse dhe secila drejtori të bëjë shpalosjen dhe evitimin e të metave që i ka konstatuar auditori i përgjithshëm.

Rasim Fazliu – pajtohem me parafolësit se këtu po bëhet fjalë për përsëritjen e gjërave që nga vitet e mëparshme, mirëpo tregon që ka edhe mjaft të gjetura në të gjitha lëmit dhe është mirë që këto gjëra të mos përsëriten por nuk e di se ky raport a i është ofruar Qeverisë së mëparshme për me dhënë ata sugjerimet dhe vërejtjet e veta. Konsideroj që Qeveria e kaluar brenda dy viteve ka realizuar aq shumë saqë të gjitha qeveritë paraprake nuk kanë mundur me bë një gjë të tillë, por edhe kjo Qeveri e tanishme pak është duke punuar në këtë drejtim. Prandaj është e natyrshme që janë paraqitur këto lëshime edhe pse edhe këto të gjetura nuk është dashtë të jenë për hyrë të korrektësisë, por është mirë që Qeveria e tanishme të mos i përsëritë gabimet që kanë qenë të përsëritura vazhdimisht në të gjitha qeveritë e deritanishme.

Esad Haxhijaha – kam krijuar bindje se kjo punë kryhet sa për të thënë se është kryer sepse nga vërejtjet e dhëna nuk ka kurrfarë dobi, por duhen shqyrtuar dhe duhet dhënë mendimin dhe për lëshimet që janë të natyrës më drastike duhet të kërkohet edhe përgjegjësia. Kisha pyetur se nuk më është e qartë se ku është ndërtuar gropa septike në lagjen “Strana” dhe me çfarë ka të bëjë ndarja e ndihmës nevojtarëve në vlerë prej 7.900 € prej tyre 2.900 janë ndarë ndërsa të tjera nuk dihet se ku kanë shkuar. Pastaj një projekt i realizuar në vitin 2009 rreth kufizimit të hapësirës për hedhjen e mbeturinave, janë vendos disa shtylla dhe nuk e di kujt i është dashur ajo dhe tani është krijuar një pamundësi e hedhjes së mbeturinave dhe thuhet që ky projekt ka kushtuar 18.000 € që është shumë e madhe dhe lë hapësirë për të dyshuar se janë keqpërdorur mjetet e buxhetit dhe po krijohet bindja se te ne po vrapohet për postet dhe funksionet për të përfituar.

Avdullah Kryeziu – menaxhimi i pronës së Komunës, objekteve, impianteve dhe pajisjes është problem në vete dhe nëse është formuar një Komision për regjistrimin e pronës dhe nuk ka evidentim të pronës, nuk ka evidentim të mjeteve, të inventarit, atëherë shtrohet pyetja çka punon ky Komision, nëse nuk ka mundësi me regjistrua ne free-balance në aspektin elektronik.. Në bazë të raporteve të auditorëve ky regjistrim nuk ekziston fare dhe është rrezik që të humben prona, vetura, kompjuterë dhe asete tjera dhe ky është problem që duhet zgjidhur Komuna në të ardhmen.

Kryesuesi – të gjitha rekomandimet që kanë dal nga ky raport të ketë parasysh Qeveria komunale, në mënyrë që për çdo vit të kemi së paku përmirësime me një përqindje të caktuar dhe në të ardhmen të kemi një Qeveri më të mirë dhe më funksionale e gjithashtu mbetet që kryetari i Komunës të formoj Komitetin e auditimit që është detyrë e domosdoshme.

4. Shqyrtimi i projekt Aktivimit për aprovimin e kërkesës së Gëzim Jahir Shala nga Xërxa, për lejin e ndërrimit të patundshmërisë.

Kryesuesi – edhe këtë pikë e kemi shqyrtuar në KPF dhe ju informoj se nuk kemi mundur që të dalim me një qëndrim të përbashkët, mirëpo për atë çka jemi pajtuar kemi pasur pak vërejtje në lëndë e në anën tjetër kam kërkuar që vetë pronari i kësaj kërkesë të merr pjesë në këtë seancë dhe të jep sqarime lidhur me këtë investim që do të bëhet. Gëzim Shala kërkon që të bëjë ndërrimin e një sipërfaqe për zhvillimin e veprimtarisë për përpunimin e letrës në parcelën e cila gjendet në rrugën për Opterushë. Kjo sipërfaqe është një hektarë e cila sipërfaqe i është dhënë nga Kuvendi komunal n; shfrytëzim për periudhë dhjetë vjeçare aq sa edhe lejon ligji, ndërsa tani për shkak se është në negociatë me Bankën evropiane dhe pritet të ketë një investim rreth 5 milion €uro mirëpo kërkojnë që kjo pronë të jetë në emër të tij.

Gëzim Shala, parashtues i kërkesës për ndërrim të patundshmërisë – veprimtaria ime është Fabrika për prodhimin e kartonit dhe ambalazhe e cila gjendet në rrugën Rahovec – Opterushë. Veprimtarinë e kam filluar në vitin 2004 në Gjakovë në një objekt me qira. Pas dy viteve pune atje u arritën kushtet për ndërtimin e objektit dhe po nga ky Kuvend komunal e fitova mundësinë për ndërtimin e objektit në sipërfaqen prej një hektarë të cilën momentalisht e kam në shfrytëzim. Në këtë sipërfaqe kam bërë ndërtimin e objektit dhe kam zhvilluar veprimtarinë me afarizëm të suksesshëm deri në vitin 2009 ku në këtë vit kam hyrë në negociatë me Bankën evropiane për zhvillim dhe rindërtim për të cilën kam edhe argumente që jemi në bisedime për zgjerimin e kësaj veprimtarie. Si zgjerim i vetëm i mundshëm i kësaj veprimtarie është procesi i riciklimit të letrës mbeturinë të cilën besoj se do ta realizoj shumë shpejtë, mirëpo për realizimin e këtij projekti kërkohen disa kushte. Dy herë kanë qenë në vizitë përfaqësues të Bankës evropiane për zhvillim dhe rindërtim të cilët kanë bërë analizën e sasisë së mbeturinës dhe parakushteve tjera të cilat janë apo nuk janë të mundshme për zhvillimin e këtij procesi në territorin e Kosovës. Pasi që kanë bërë analizat e veta në dy vizitat e përfaqësuesve të tyre, për çka edhe kemi raporte të vizitave, materialin të cilin e kemi dorëzuar në dosje. Në këto dy raporte është parë një hap pozitiv një mundësi e mirë për realizimin e këtij projekti në territorin e Kosovës e sidomos e kanë përzgjedh Komunën e Rahovecit. Si vetëm në këtë lëmi jam më afër realizimit të këtij projekti, kështu që kanë ardhur në ato faza që prej Bankës evropiane kërkohet që pronësia në të cilën zhvillohet veprimtaria të jetë pronë personale. Pasi që kjo momentalisht nuk është pronë personale, kam parashtuar një kërkesë pranë Kuvendit që të bëjmë një ndërrim prone mundësisht që t’i japim mundësi Bankës evropiane për investim dhe për zhvillim. Ky projekt është shumë i rëndësishëm në nivel të Kosovës e sidomos për vendin në të cilin ndërtohet. Do të punësohen mbi 250 punëtorë në nivel të Kosovës, ndoshta duket shifër e madhe, por është shumë reale sepse do të hapim pikat e grumbullimit të mbeturinës në të gjitha qendrat e Kosovës, ku do të punësohen minimum 150 punëtorë në terren dhe minimumi është 100 punëtorë në vetë procesin e riciklimit. Duke parë një rëndësi të veçantë, besoj që edhe tek asamblistët e KK të Rahovecit do të ketë një mirëkuptim, pasi që të gjithë tentojmë në zhvillim dhe aludojmë në zhvillim ekonomik, shpresoj se do t’i jepet përkrahje këtij investimi. Kisha edhe

një kërkesë tjetër që në aktvendimin të cilin e ka bërë Kuvendi komunal pika II e aktvendimit sipas Bankës evropiane është e papranueshme, pasi që ata kërkojnë që pronësia të jetë private, e pa dyshuar dhe e pakushtëzuar. Shpresoj që asamblistët do të votojnë në të mirë dhe në interesin e qytetarëve të cilët presin punë.

Rrustem Thaçi – pyetja e parë është që pronën të cilën e ke për ndërrim a është pronë private apo shoqërore. Nëse e ke kushtin a ka të bëjë me hipotekë apo në formë garance?

Gëzim Shala – prona të cilën e ofroj është pronë private dhe është pronë e shumëhershme private dhe është në emër personal timin. Kjo parcelë sigurisht që do të jetë edhe në formën e hipotekës pasi që është një donacion shumë i madh.

Feim Fetoshi – e përgëzoj Gëzimin për të arriturat e bëra në biznes, uroj që edhe projektet që ke filluar të realizohen dhe besoj se do të realizohen duke të njohur ty në këmbëngulësi që ke për punët që ke filluar dhe do t'i dalësh në fund. Do të bëjë një pyetje për dy çështje teknike, natyrisht që ky është një investim shumë kapital dhe shumë domethënës. Ju thatë vetëm për punësimin e punëtorëve por të gjithë e dimë që është shumë i rëndësishëm për mbrojtje të ambientit ndërsa Kosova ka shumë nevojë për mbrojtje të ambientit. Por, për një investim të tillë a mjafton sipërfaqja që ke në dispozicion prej një hektari dhe për shkak se një investim, një përpunim teknologjik i tillë kërkon harxhim të madh të ujit, a ke ujë të mjaftueshëm dhe cilësor.

Gëzim Shala – sa i përket procesit të mbrojtjes së ambientit është një projekt i vetëm pasi që është riciklim që bënë kryesisht mbrojtjen dhe pastrimin e ambientit të mbeturinave kryesisht të letrës. Në qoftë se hymë në këtë aspekt kemi shumë të mira, si njerëz, si shoqëri ku fillimisht ky projekt shihet si projekt me interes personal për projektuesin, mirëpo interesat janë të përgjithshme. Ne kemi bërë një krahasim shumë të vogël dhe shumë thjeshtë, duke u bazuar në disa karakteristika dhe statistika në Kroaci dhe kemi ardhur në përfundim që letër mbeturinë krijon çdo familje dhe në qoftë se kjo letër mbeturinë në qoftë se për një periudhë jo të gjatë mbledhet dhe grumbullohet, atëherë do të siguron çdo familje me mbeturina që momentalisht e ndotin ambientin do të siguroj një sigurim social. Sasi të ujit kemi të mjaftueshme pasi që kemi bërë hapjen e pusit në parcelën në të cilën ndodhemi, mirëpo edhe nuk kemi ndotjen e ambientit me ujë pasi që uji është proces rikthyes.

Salih Hoti - parcelën të cilën ti e ofron në vendin e quajtur “Dell” në Zatriq më intereson të di prej sa kohësh e këtë pasuri. Këtë pyetje e bëra për shkak se mund të lindin konteste më vonë dhe çdo kontest pas aprovimit të Kuvendit të Komunës është me pasoja të gjithanshme.

Gëzim Shala – kjo parcelë është për një kohë shumë të gjatë në emër personal të njerëzve privat që nuk ka lidhje me pronë shoqërore ndërsa si pronësi e imja është që nga viti 2011, por kisha kërkuar prej të gjithëve që krahasimin mes meje dhe të atyre të cilët kanë bërë krime të jetë sa më larg për arsye se deri sa të tjerët kanë bërë ndërrime të pronave për interesa thuaj se personale dhe për shitje të mëtutjeshme, në këtë rast kemi të bëjmë me një ndërrim prone për një parcelë në të cilën është duke u zhvilluar veprimtaria dhe në të cilën argumentohet se do të bëhen investime.

Labinot Berisha – ju përmendët që potencialisht pritni donacion nga Komisioni evropian rreth 5.5 milion Euro, zakonisht pritjet dalin edhe me përgjigje negative nga donatori. Nëse përgjigja do të jetë negative a keni kapacitete nëse ne ju japim pronën përpara përgjigjes që ju të implementoni këtë projekt.

Gëzim Shala – ky donacion pritjet të jepet, mirëpo si proces i prodhimit të kartonit që momentalisht e kam është proces gjysmak në qoftë se nuk arrihet edhe procesi i riciklimit të letrës mbeturinë, kështu që ky projekt është i detyrueshëm të unë, me ose pa Bankën evropiane ky projekt do të realizohet.

Fatmir Kadiri – sa kanë arritur shifrën investimet e juaja në infrastrukturën respektivisht objektin e juaj në vendin ku veproni?

Gëzim Shala – investimet momentale e kalojnë shifrën 3 milion Euro dhe kisha pasur shumë dëshirë që të gjithë Ju të vini dhe së paku njëherë t'na vizitoni dhe nga vetë prezenca e juaj do të vini në përfundim që investimi kalon 3 milion.

Esad Haxhijaha – u tha se do të punësohen rreth 250 punëtorë pas realizimit të projektit, a do të punësohen njerëz në këtë objekt apo në të gjitha qendrat ku bëhet riciklimi. Së dyti thoni se do të realizohen 5.5 milion € dhe banka e cila ofron këtë mundësi kërkon që prona të jetë private dhe thatë se kjo duhet të jetë si hipotekë. Çfarë hipoteke mund të jetë prona e cila nuk kushton as 50 mijë € ndaj pesë milionësh dhe konsideroj se hipoteka duhet të jetë në vlerë prej shumës që kërkohet. Përveç kërkesës unë pash edhe një propozim të aktvendimit dhe nuk më është e qartë se si është bërë nëse nuk ka kaluar edhe në KPF dhe një shkresë tjetër në të cilën thuhet se Banka evropiane nuk pajtohet nëse qëndron kushti i pikës II të aktvendimit. A ka të bëjë me kohën e shkurtër apo çfarë është arsye tjetër, nëse 3 vjet është kohë e shkurtër për realizimin e këtij projekti atëherë të bëhet për periudhë më të gjatë për 10 vite, por nuk mund të jepet ndryshe. Çka nëse pas aprovimit të aktvendimit nuk realizohet ai projekt?

Gëzim Shala – si argument fillestar z.Esad ju jeni ata të cilët më keni dhënë në shfrytëzim parcelën të cilën momentalisht e kam dhe atëherë kur e kam marr ju kam premtuar se do të bëjmë ndërtim të objektit për Fabrikën e prodhimit të kartonit dhe ambalazhit dhe pikërisht ato fjalë dhe ato premtimet që i kemi dhënë në 2006 ato me përpikëri janë të realizuara. Bile mua ma merr mendja në qoftë se jo te tjerët te ju e kam dhënë provimin përderisa i kam mbajtur premtimet të cilat i kam dhënë atëherë. Kur e përmendët hipotekën nuk është 50 mijë por 3 milion Euro sepse ajo nuk është parcelë e thatë por ekziston objekti të cilin e kam ndërtuar ku është duke u zhvilluar veprimtaria. Në pyetje në qoftë se nuk do të realizohet kjo si do të bëhet. Ky projekt do të bëhet, por jam i interesuar që të bëhet këtu.

Feim Fetoshi – për herë të parë u njoftova me këtë informacion por kam njohuri me punën se si punon Banka evropiane për zhvillim. E kuptova mirë që vlera e tokës është shumë e vogël me vlerën e investimit dhe ai nuk mund të arsyetohet si hipotekë. Çështja është kështu: Banka evropiane për rindërtim dhe zhvillim nëse jep një kredi ajo atë vlerë e lenë

hipotekë, pra makinat të cilat do t'i blejë Gëzimi, ato do të jenë hipotekë dhe ajo nuk mund të jetë hipotekë nëse pronën në të cilën gjenden ato makina nuk është pronë e tij.

Nahit Elshani – edhe në mbledhjen e KPF kam pasur një shqetësim dhe kam kërkuar llogari dhënie nga drejtori, ku të njëjtën kohë ka ardhur aktvendimi me 3 pika dhe të njëjtën kohë ka ardhur kërkesa për heqjen e pikës II të aktvendimit dhe kam shtruar pyetjen se si është e mundur të informohet ushtruesi i kërkesës pa dalë aktvendimi në Kuvend dhe nga kush është i informuar që të bëjë kërkesën e dytë. Po të kishte ardhur sot ky dokument e jo në mbledhjen e KPF do të kishte arsyeshmëri sepse është debatuar, por të vjen pa u debatuar është një papërgjegjësi. Në mbledhje të KPF kam thënë se LDK është pro zhvillimit ekonomik, ka program për zhvillimin ekonomik dhe e mbështet zhvillimin ekonomik në këtë rast atë lokal. Po ashtu dëshmia më e mirë është se jemi pro dhe e mbështesim vetë pronën të cilën ja kemi dhënë z.Gëzim Shalës për 10 vite pronën ku ai tani afaron, mirëpo këtu ka konflikt interesi dhe në bazë të diskutimeve po shihet që ka bashkëpronarë që nuk është në rregull, sepse po e dinë më mirë se ai që ka parashtruar kërkesën. Nëse arrin me realizue kredinë ne do t'ia falim këtë parcelë pa ja marr parcelën që e ka trafikuar në mënyrë ilegale në Zatriq.

Fatmir Iska, drejtor i Drejtorisë për gjeodezi, kadastër dhe pronë – si ka mundur të parashtror kërkesë për heqjen e pikës së II-të të diapozitivit të aktvendimit. Kjo kërkesë është parashtruar në ditën kur është mbajtur mbledhja e KPF i cili komitet përbëhet prej 9 anëtarëve të cilëve materiali iu është shpërndarë 10 ditë para mbledhjes, kështu që ka qenë e mundur të shihet materiali dhe të parashtrohet kërkesa për datën kurë është mbajtur mbledhja e KPF. Ndërsa sa i përket parcelës ajo është private dhe mban numrin 530.1 dhe pse nuk është e nënshkruar duhet të dini se fletat e posedimit UN nuk nënshkruhen por janë certifikatat me gjendje të re dhe skica e terrenit është e nënshkruar, ndërsa pjesën të cilën e ka për ndërrim në Zatriq keni dokumentacion të qartë, ndoshta është bërë lëshim gjatë fotokopjimit mirëpo unë origjinalin e kam këtu të nënshkruar dhe të vulosur. Është z.k. Zatriq, certifikata nr. 83 në emër të Gëzim Shala ku është e cekur edhe sipërfaqja prej 2.10.00 ha.

Rasim Fazliu – ne si grup i këshilltarëve mendojmë që Gëzim J. Shalës duhet t'i mundësohet ndërrimi i patundshmërisë nëse ka bazë ligjore, me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë së tij për arsye të shumëfishta si punësimi i njerëzve, ruajtja e ambientit në Komunën tonë por edhe në Kosovë në përgjithësi sepse është projekti unikat si dhe me qëllim të përkrahjes së bizneseve. Do të kërkoja sqarim prej drejtorit se kush kanë qenë pronarë të mëparshëm të parcelës që ofrohet për ndërrim.

Fatmir Iska - për këto parcela zakonisht bëhet historiku dhe merr 3-4 ditë sepse ka të bëjë me shënime prej vitit 1952 e deri te pronari i fundit kështu që për mbledhje të ardhshme do të keni përgjigje.

Feim Fetoshi – sa i përket parcelës në Zatriq sipas meje nuk është aq interesante për arsye se unë besoj që dokumentet që lëshohen nga kadastrë janë dokumente zyrtare dhe nëse dikush lëshon dokumente jo valide natyrisht përgjigjet për vepër penale. Ne si Kuvend komunal jemi organ zyrtar dhe dokumente që na vijnë duhet të kenë bazë ligjore. Banka evropiane kur jep kredinë donë dokumentacion strikt të rregullt dhe toka në të cilën gjendet objekti duhet të jetë pronë private e nuk është çështja se sa e ka vlerën. Unë i besoj një projekti të tillë, besoj që Banka evropiane për ndërtim dhe zhvillim nuk hyn në projekte kote dhe mbi të gjitha i gëzojmë faktin që në Rahovec mund të ndërtohet një fabrikë e cila para se gjithash e ruan ambientin, andaj bazuar në këtë princip mendoj që ia vlen që ne si Kuvend komunal të japim aprovimin për këtë pikë në mënyrë që këtij njeriu t'ia hapim rrugën për investim të tillë. Me përgjegjësi morale, penale dhe politike deklaroj që nuk jam bashkëpronar por asnjë dyshim më të vogël nuk ka që kam biseduar me dikë e as që bëjë pazarllëqe për kesi gjëra.

Sinan Ejupi – ne si grup i këshilltarëve edhe në KPF jemi deklaruar pro këtij aktvendimi të cilin e keni përgatitur dhe atëherë kemi thënë se nuk kemi nevojë të hyjmë më thellë se kush është e kush nuk është për zhvillim, kush ka e kush jo program dhe ma merr mendja se të gjithë kanë program, mirëpo shpeshherë ne dimë të kemi vetëm programe dhe kur bëhet në vepër i kërkojmë disa hollësi, por jam për atë që çdo send që bëhet këtu duhet të jetë e mbuluar ligjërisht. Nëse ky ndërrim i parcelës është ligjor atëherë ne do të jemi para dy dilemave. Njëra është nëse bëhet realizimi i projektit sipas kërkesës së z.G.Shala që do të ishte një gjë shumë pozitive për Komunën por po e marrim që nuk do të aprovohet ai projekt nga Bashkësia evropiane ndërsa ne e kemi dhënë këtë tokë, nuk shohë çfarë të keqe ka nëse një fabrikantit i jepet, i zyrtarizohet një hektarë tokë në mal dhe nesër e zgjeron veprimtarinë, çka ka humbur në këtë rast Komuna e Rahovecit dhe ne si deputet dhe çfarë gabimi kemi bërë, kur e dimë se çfarë papunësie e madhe është, çfarë prapambeturi teknologjike kemi ne etj. Ne duhet më tepër të punojmë në mënyrë pragmatike dhe logjike dhe e mbrojmë qëndrimin që nëse ka nevojë edhe ti ndihmojmë. .

Salih Hoti – propozoj që ne pronën komunale t'i japim Gëzimit për 5 vite me kusht që investimi të ndodh dhe pasi të ndodh investimi kjo pasuri të jepet pa ndërrim fare.

Rexhep Oruçi – zotëriun Gëzimin e njoh si afarist shumë të suksesshëm sepse kam pasur rast të bashkëpunoj me firmën e tij e disa herë edhe si garantues i tij, është shumë ambicioz dhe atë çka e flet do të realizoj. Nuk dyshoj se ai ka mundur të bëjë dallavere rreth ndryshimit të pronës ngase e njoh egon e tij dhe nëse përcaktohet Asambleja që t'i mundësoj ndërrimi e pronës atëherë të mos e kushtëzojmë sepse atë nuk e pranojnë as bashkat vendore e lëre më Banka evropiane por edhe po t'ia falë Komuna këtë pasuri nuk do të dëmtohet sepse kjo është në interes të Komunës si që është mbrojtja e ambientit, punësimi etj., prandaj jam për atë që ti mundësohet ndërrimi dhe heqjen e kushtit të pikës II të aktvendimit.

Avdullah Kryeziu – kërkuar Gëzimi ka kërkuar këtë parcelë të cilin Kuvendi ja ka ndarë në vitin 2006 dhe normalisht ekzistojnë procedurat që mund t'i bëjmë edhe për disa vite më tepër, megjithatë më duket që propozuesi i cili ka sjell këtë propozim lë dyshime. Sipërfaqja e cila i ofrohet KK-së me nr. 1122 në Zatriq që u dëshmuar nga pagesa që është bërë

shumë vonë, sipërfaqja është 3.40.00 ha ndërsa nga dokumenti i drejtorit shihet që janë 2.10.000 ha dhe këtu paraqitet një lloj dyshimi. Çmimi i kësaj sipërfaqe të cilën ja kemi ndarë ne në vitin 2006 tani çmimi real është 100.000 € ndërsa në Zatriq mund të blesh sipërfaqen prej 50.000 € që del sipas kësaj se Gëzimit po ia falim 90.000 €. Pyetje për drejtorin: pos këtij propozimi të kërkuesit a ka ndonjë pronë tjetër në pronësi të vet dhe a ka hulumtuar drejtori në këtë drejtim ngjitur me pronën të cilën e ka në shfrytëzim. Unë kam njohuri që ka një sipërfaqe prej 0.90,80 ha që është numri i parcelës 266 është parcela të cilën ja ka ndarë Kuvendi komunal ndërsa parcela 267 dhe 268 është e Gëzim Shalës. Nëse dëshiron të bëjë ndërrim atëherë le të jep ai sipërfaqen e vet e ne ja japim sipërfaqen e Komunës ose ia falim ashtu siç vendos Kuvendi.

Fatmir Iska – parcela 1122 është në sipërfaqe prej 2.10,00 ha ndërsa pjesa tjetër nuk jepet për kompensim dhe proporcioni është 2:1 ndërsa sa i përket asaj se a ka Gëzimi prona tjera kishte me qenë më mirë që atë të tregoj vetë.

Xhemali Haxhimustafa – nëse del kjo që Gëzimi që ka pronën e vet dhe të përfitojë edhe dy hektarë kategorikisht jam kundër ndërsa nuk ekziston kjo duhet t'i mundësojmë që të bëhet një investim i tillë. Ne kemi mundësi jo vetëm që të kritikojmë apo të lypim përgjegjësitë por mund të japim edhe alternativa dhe në qoftë se zotëriu nuk ka mundësi të realizoj atë projekt pa pasur pronë të vet të paluajtshme, ne mundemi me marrëveshje të ndryshme të cilat do të vërtetohen në gjykatë dhe të çekim se në afatin 10 vjeçar i jepet e drejta e shfrytëzimit të kësaj prone si pronar pa të drejtën e tjetërsimit, të drejtën e hipotekimit deri në realizimin e projektit ndërsa me rastin e realizimit bëhet titullar i plotë.

Labinot Berisha – kam një propozim për kryetarin dhe i njëjti të shënohet në procesverbal për Drejtorinë për kadastër, gjeodezi dhe pronë që të hap një vend të punës për një falltore dhe kur kemi këso raste për prona le të qet fall a ka me hile a është pa hile, sepse sa herë që vjen çështja e pronave shohë këtu që vijnë ekspertë të ndryshëm të Komunës dhe jashtë saj që e mbrojnë me shumë zili investimet ose jo investimet që personalisht gjithëherë jam i disponuar që të abstenoj votën time sepse shpirtërisht ndihem jo i sigurt që a është vërtet për investim apo ka ndonjë hile brenda këtij investimi.

Fatmir Iska – parcela 268 është parcelë e Komunës ndërsa parcela 268/1 dhe 267 figuron në emër të Gëzim Shala dhe ka të bëjë me një sipërfaqe prej 92 ari.

Lirih Berisha – kisha kërkuar prej këtij Kuvendi duke parë edhe vullnetin e Gëzimit për punë që t'ia aprovojmë këtë kërkesë.

Burim Krasniqi – unë personalisht jam pro që t'i jepet kjo parcelë kërkuesit për arsye të vetme që konsideroj se materialin që kemi ne, si fletë poseduese, skicë janë të sponsoruara prej Qeverisë lokale dhe për çdo parregullsi që përmban ky dokumentacion përgjegjësi mban Qeveria lokale.

Rukije Krasniqi – këtë projekt aktvendim e kemi shqyrtuar edhe në KPF dhe të gjithë kemi qenë pro ndërsa tani u ndryshuan raporte dhe po thuaj se tërësisht është ndryshuar edhe personi kërkues. Para dy vite kemi dhënë 2:1 një pronë të Komunës ndërsa tani është e kundërta me gjithë që ky investim po thuajse regjional që as shtetet e regjionit nuk e kanë siç është riciklim i letres që është në të mirë e gjithë shtetit të Kosovës. Përveç që është në dobi të interesit të ambientit përfitojnë edhe individë sepse është në pyetje edhe zbutja e papunësisë. Lidhur me sipërfaqen prej disa ari që doli tani, personi në fjalë ka thënë që duhet edhe një pjesë dërmuese e tokës për zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarisë së tij, sepse edhe vetëm thamë që në një hektarë nuk mund të realizohet ajo veprimtari. Duke marr parasysh që ka pronën e vet dhe duke e zgjeruar edhe me një hektarë tjetër të pronës shoqërore ai dëshiron të zgjeroj pronësinë e kjo është që t'i ndihmoj KK-ja dhe duhet t'i ndihmoj qytetarëve të Komunës sonë. Tani parashtrohet pyetja a do t'i ndihmojmë qytetarit të Komunës apo jemi pengesë e qytetarëve dhe nuk e di kah po orientohejmë dhe kah po shkojmë dhe cili është qëllimi i këshilltarëve komunal.

Rrustem Thaçi – pasi që kemi votuar në këtë Kuvend për ti dhënë shtetasit turk 11 hektarë për të investuar në Komunën tonë propozoj që të aprovohet edhe kërkesa e Gëzimit.

Smajl Latifi – ne po përpiqemi të gjejmë modalitetin e përshtatshëm si të ndihmojmë një projekt investiv. Në qoftë se ka kushte të përshtatshme që të kalohet në këtë mënyrë, ju jeni ata që vendosni, mirëpo edhe Gëzimi është dashtë të na informoj dhe të jetë korrekt dhe të tregoj se ka 2 ha dhe i duhen edhe 5 ha. Në parim unë jam pro, por a është modaliteti më i mirë dhe a është momenti më i përshtatshëm për të vendosur që tani apo jo është çështje që ju takon juve.

Esad Haxhijaha – nuk është mirë që të debatohet për diçka që ka fakte, argumente dhe të krijojmë njëanësi dhe ndarje në Asamble. Tani dikush është në mënyrë tendencioze pro e dikush në mënyrë të singertë si dhe me fakte e argumente thotë që të mos ngutemi dhe mendoj se nuk duhet të ngutemi. Unë e di që zona industriale në drejtim të Opterushës është pronë komunale dhe është e pakuptueshme se prej kujt e ka blerë Gëzimi gjë që duhet të vërtetohet e gjithashtu duhet të vërtetohet se pronë e kujt ka qenë në Zatriq që ka blerë. Të gjitha vendimet që janë marr nga viti 1997 e këndej nuk janë valide sepse nesër mund të anulohen. Unë sot po dëgjoj që para dy muaj prona e komunës prej 7 hektarësh në rrafshin e Opterushës është privatizuar dhe kjo duhet të vërtetohet se si është privatizuar, nga kjo propozoj që kjo çështje të debatohet në mbledhjen e ardhshme pas kompletimit të shënimeve të nevojshme dhe nëse është e vërtetë Gëzimi ka pronën e blerë atëherë këtu ka të bëjë me tendencën e përfitimit dhe Asambleja komunale nuk guxon të bie në këso kurthe. Prona e Komunës nuk mund të falet e as të tjetërsohet, nuk mund të jepet në këtë mënyrë sepse pastaj do të kemi me qindra kërkesa të këtilla. Nuk pajtohem me një ndarje kësajsoj të delegatëve sepse të gjithë jemi përgjegjës për interesa të qytetarëve, të Komunës por jo edhe për ofrime për përfitime individuale.

Kryesuesi – edhe unë në një formë kam qenë në dilemë me këtë aktvendim por në një farë nuance duke llogaritur në atë që vërtetë është mirë t'i përkrahim investimet vendore, por kjo tani që ndodhi, atë që e ceku A.Kryeziu që ky kërkues një

pronë, e kjo lë të dyshohet që kjo lëndë nuk ka pasur asgjë tjetër përveç një mashtrim që është dashtë me na u bë neve Kuvendit të Komunës. Ne jemi për t'i ndihmuar zhvillimit ekonomik por në këtë formë jo sepse ne jemi pronar e të gjithë pronës që posedon Komuna e Rahovecit. Ne jemi i vetmi faktor që kemi mbetur për mbrojtur pronën e Komunës sepse në çdo anë tjetër prona e Komunës shkëputet dita ditës dhe ndoshta një ditë do të mbesim fare pa pronë. Nuk po shoh efekt pozitiv për këtë lëndë që jemi duke e trajtuar por kemi të bëjmë me lajthitje nga ky qytetar.

Feim Fetoshi – unë jam këshilltar komunal nga viti 2007 e këndeje dhe nga të gjitha transferet e pronave që janë bërë, arsyetim më të mirë, më të ndershëm dhe më praktikë se kjo që ka ardhur sot nuk kemi pasur. Gjatë kësaj periudhe disa raste kanë qenë shumë tendencioze siç është te dhënia e pronës z.Fadil Gashit në sipërfaqe prej 70 ari ku prona ka vlerë shumë të madhe në kompensim të një vlere shumë më të vogël dhe kryesuesi i atëhershëm ka bërë konstatimin që nëse brenda një ose dy muaj nuk realizohet kushti që ka pasur të ndërtojë zonë septike vendimi do të bie prej fuqisë dhe me sa e di unë ende ajo gropë septike nuk është bërë. Po ashtu në kundërshtim të LVL që duhet të veten banorët, pra i është dhënë prona atij zotëriu nga Turqia edhe pse unë ende dyshoj se ajo mund të realizohet sepse kjo është në kundërshtim të të gjitha interesave, ndërsa tani këtu bëhet fjalë për mbrojtje të ambientit, për një investim madhor, por megjithatë unë ja bëra pyetje direkt në aspektin profesional G.Shalës që a mjafton një hektarë dhe ai është përgjigjur se momentalisht po ndërsa tani doli që ka dy prona këtu. Tani kur u vërtetua se ka dy prona jam në dyshim dhe nëse votohet do të abstenoj ndërsa propozoj që ky projekt të mos humbet është mirë që të shtyhet kjo dhe të sqarohen këto dy prona.

Nahit Elshani – pajtohem që kjo pikë të shtyhet për mbledhje tjetër dhe të vërtetohet çështja e këtyre dy pronave që i ka Gëzimi të ngjitura me pronën ku afaron me biznes si dhe historiat për pronën në Zatriq.

Sinan Ejupi – nuk mundet Gëzimi në një hektarë të zhvillojë biznesin sepse riciklimi kërkon sipërfaqe të madhe por me siguri ai ka menduar që edhe me një hektarë tjetër do t'i mjaftonte për kryerjen e biznesit.

Rasim Fazliu – fillimisht u shprehja edhe në emër të Grupit që ne i përkrahim programet zhvillimore që të ndodhin në Komunën e Rahovecit si në rastin e Gëzimit, mirëpo edhe unë jam pak sa i zhgënjyer, por nuk e di se çka do të kishte me dëmtua procesin sikur të kishte treguar se ka një parcelë por dëshiron të rrit parcelën dhe këtu qëndron edhe gabimi i tij. Në emër të grupit të këshilltarëve propozoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhje të ardhshme, të pastrohen gjëra mirë e mirë e pastaj të del në aprovim.

Smajl Latifi – ju premtoj që nga dita e nesërme do të filloj studimi i hollësishëm i këtyre çështjeve të cilat u ngritën dhe do të keni shumë më qartë se cila është e vërteta, cilat janë fakte që flasin lidhur me këto prona. Ne nuk po flasim ta ndajmë me projektin investiv sepse është temë krejt tjetër, gjithsesi jemi për projekte investive, jemi për me i dhënë mundësi njerëzve tanë, por ne do t'ju bijmë një informatë të plotë se cila është e vërteta për pronat dhe jam dakord që të shtyhet për seancën tjetër.

Kryesuesi pas hedhjes në votim ka konstatuar se me shumicë votash kjo pikë **shtyhet** për një nga mbledhjet e ardhshme.

4. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve.

Smajl Latifi – përgjigje në pyetje të Feim Fetoshit, nga mbledhja e KPF për Drejtorinë e Shëndetësisë pse nuk është zbuluar busti i dr.Fahredin Hoti në QKMF Rahovec më 14 qershor – Ditën e çlirimit. Përgjigje: KK Rahovec më 12.04.2011 ka marr vendim për ndarjen e mjeteve për ndërtimin e bustit dr.Fahredin Hoti në oborrin e QKMF në Rahovec. Kryesuesi ka marr vendimin për ndërrimin e kodit respektivisht për ridestininimin e mjeteve prej kodit të Rregullimit të varrezave të dëshmorëve në Komunën e Rahovecit në kodin – Ndërtimi i bustit dr.Fahredin Hoti në Rahovec. Drejtoria për financa dhe buxhet përmes kryetarit të Komunës me shkresë i është drejtuar Ministrisë për financa dhe buxhet të Kosovës për ridestininimin e mjeteve, mirëpo kjo kërkesë nuk është aprovuar me arsyetimin se këto mjete janë të parapara të alokohen në muajin korrik dhe shpresojmë se në korrik do të përmbushim obligimin.

Përgjigje në pyetje të Rexhep Oruçit, 1. Furnizimi i një pjese të qytetit me ujë të pijes 2.Shembja e një pjese të rrugës të varrezat ortodokse në Rahovec: Rreth pyetjes së parë sot kemi debatuar mjaft. Te shembja e rrugës shpresojmë që edhe këtë të zgjidhim me rishikim të buxhetit.

Përgjigje në pyetje të Rr. Thaçi dhe E.Zhuniqi, në lidhje me kanalin e ujitjes Xërxë-Bellacërkë. Ai kanal është në kuadër të projektit të Ministrisë së bujqësisë që është dhënë së bashku me ujin e pijes, mirëpo tani ka ngec thuar se në gjysmë të rrugës për arsye se pjesë që kanë mbetur afër nuk po mundën me akumulue ujin që bjen dhe tani po kërcënohemi nga ujërat atmosferik dhe nuk ka ndodh që në mes të Xërxës dhe Bellacërkës të përmyten arat me ujë.

Kontrata për kullimin e kanalit të kullimit Fortesë-Xërxë dhe zgjerimit të sistemit të ujitjes në lokacion Sopniq-Potoqan-Fortesë dhe Rahovec është nënshkruar më datë 08.09.2009 në mes të MBPZHR dhe punë kryesi është NPT "Xërxa" me pronar Reshat Kryeziu. Vlera e kontratës ka qenë 998.167,80 €. MBPZHR ka marr pjesë në 90% të vlerës së kontratës në shumë prej 898.351 € ndërsa KK Rahovec me 10% të vlerës ose 99.816 €. Sistemi i ujitjes është përfunduar ndërsa kanali i kullimit është ndërprerë për shkak të kontestit pronësor. Në nenin 5 të Memorandumit të mirëkuptimit thotë se KK-ja në bashkëpunim me Shoqatën apo grup të tjerë të fermerëve kanë obligim zgjidhjen e të gjitha kontesteve pronësore si dhe të gjitha problemet tjera të mundshme që mund të paraqiten gjatë punimit. Pra, MBPZHR e fajëson Komunën për mosrespektim të nenit 5 të Memorandumit të mirëkuptimit me të cilin është dashtë të zgjidhet ky kontekst pronësor juridik. Disa herë me kërkesë ju kemi drejtuar MBPZHR për vazhdimin e asaj pjese të mbetur, por përgjigja është se kontrata është nënshkruar në vitin 2009 dhe me Operatorin NTP "Xërxa" ka përfunduar për shkak të vitit fiskal dhe nuk ka mundësi vazhdimi i kontratës, por e vetmja mundësi është të bëhet një projekt për pjesën e mbetur kështu që përgjegjësia i mbetet ish Qeverisë komunale për mos respektim të Memorandumit dhe të mos zgjidhjes së problemit, por tani ne si Qeveri e re do të mundohemi që në një afat optimal të përpiqemi që të zgjidhim këtë problem.

Përgjigje në pyetjen e Lirih Berisha: Do të përpqemi që gjatë kohës kur të shpallim tenderin për mirëmbajtje të rrugëve, dhe të shohim mundësinë e zgjidhjes të këtij aksi rrugor dhe shpresojmë që të futet në listë dhe të bëhet rregullimi i pjesëve të dëmtuara të kësaj rruge. Lidhur me 4 punëtorë ne kemi disa projekte sezonale që lidhen me punësimin publik dhe është një projekt i pastrimit dhe rregullimit të shtratit të përroit në Malësi të Vogël i cili nënkupton edhe punësimin e mbi 28 punëtorëve kështu që do të përfshihen edhe këta 4 punëtorë dhe sado pak të ndikojmë në zbutjen e këtij problemi.

Këto përgjigje i dhashë në emër të këtyre drejtorëve të cilët mungojnë me arsye për shkak të angazhimeve tjera.

Rasim Fazliu – në këtë Kuvend vitin e kaluar e kam parashtruar një shqetësim të banorëve të disa fshatrave përreth aty ku unë jetoj, për përmbytjet që shkaktohen nga të reshurat atmosferike që përfshijnë qindra hektarë, mirëpo nuk janë ndërmarr kurrfarë hapa konkrete edhe pse e di që komuna jonë nuk ka buxhet vetanak për të zgjidh këtë çështje, mirëpo kanë munguar iniciativat për të rregulluar këtë zonë. **Pyetja** për Drejtorin e bujqësisë respektivisht Kryetarin e Komunës: MBPZHR sa jam i informuar unë ka hapur tenderë për disa çështje ndërsa ajo çka më intereson është sistemi i kullimit gjegjësisht drenazhimi i tokave bujqësore ku kam parë që në Komunën e Rahovecit janë përfshirë fshatrat Gexhe, Malësi e Vogël dhe Ratkoc gjë që nuk jam kundër kësaj, mirëpo nëse bazohemi në prioritetet mendoj se më shumë kanë nevojë si Celina, Fortesa dhe Xërxa, prandaj pse nuk i është dhënë prioritet këtyre fshatrave?

Smajl Latifi – ministri i bujqësisë ka qenë këtu dhe ne kemi kërkuar që kanali i kullimit të tokave që vërshohen nga ujërat atmosferike dhe që përmbajnë lagështi në vazhdimësi, si për Celinë, Ratkocin dhe Malësinë e Vogël, janë prioritetet të cilat ndërlidhen dhe në qoftë se mbështeten nga MBPZHR do të prodhojnë efekte të qarta në rikthimin e tyre në gjendjen normale dhe krijimin e mundësive që këto toka të jenë prodhuese në këto zona.

Labinot Berisha – kam një rekomandim për 4 punëtorë nga Drenoci, ideja është që ne si institucion duhet t'iu paguajmë atyre nëse ata kanë kontratën prej Komunës pavarësisht se kush ka qenë në atë kohë në Komunë, e nëse nuk kanë kontratë dhe ju si shenj konsiderate për ata unë admiroj nëse ju i krijoni mundësinë që së paku të angazhohen, por faji është i tyre sepse ata nuk kanë pasur kontratë dhe kanë punuar në emër të Komunës në mirëmbajtjen e rrugës. **Pyetje:** edhe pse llogaritet investim është shumë i vogël në Denjë, besoj që edhe ju tani e keni parë që hyrja në Shkollë është rrezik i madh për fëmijët, sepse është fryrë ajo pjesë e xhamave dhe një prekje e vogël mund të jetë rrezik potencial për jetën e fëmijëve aty. Besoj që gjatë sezonit të verës mund të intervenohet bile së paku që ato xhama të largohen.

Smajl Latifi – ne kemi projekt për meremetim të shkollave mirëpo kemi fituar dy projekte të MPL nga fondet e IPO-s të cilat janë të dedikuara për infrastrukturë të shkollave dhe kjo do të thotë që neve na jepet mundësi që të ndërhyjmë në pozicione të tilla. Ne e kemi të qartë që në këtë shkollë duhet të ndërhyhet menjëherë dhe kjo punë do të kryhet në këtë sezon para fillimit të vitit të ri shkollor. Ndërsa të pyetja që lidhet me 4 punëtorë nuk kemi bazë juridike për t'i shpërblyer. Ne kemi nevojë për mirëmbajtje të rrugëve por nuk ke mi mundësi juridike për t'i punësuar këta punëtorë dhe e vëmja gjë që na mbetet për më të shpërblyer këta njerëz që me projektet e punësimit sezonal që janë nga Ministria e punës dhe të paguhen nga operatori ndërsa tjetër mundësi aktualisht nuk kemi.

Rrustem Thaçi – deri ku ka arritur gjendja me bursat e studentëve të Komunës.

Smajl Latifi – është shpall konkursi për bursa dhe pas përzgjedhjes të përfutuesve të bursës në bazë të kriterëve të përcaktuara konkurs do t'ju informojmë. Konkursi është shpallur për ndarjen e 30 bursave për vitin akademik 2010/2011 si dhe është dhënë urdhër për pagesën e bursave studentëve të cilët janë shfrytëzues të bursave.

Burim Krasniqi – deri më tani asnjëherë nuk kemi marr informatë mbi punën e Komitetit për politikë dhe financa dhe a do të bëhet rishikimmi i Buxhetit për këtë vit.

Kryesuesi – ky Komitet përbëhet nga anëtarët e të gjithë subjekteve politikë dhe sipas rregullave në fuqi Komiteti nuk paraqet raport mbi punën e vet.

Smajl Latifi – nuk ka asnjë siguri por mund të them që rishikim të Buxhetit në Qeverinë e Republikës së Kosovës sipas të gjitha gjasave nuk ka ndërsa ne do të kishim dëshirë dhe jemi të gatshëm që të bëjmë rishikim.

Rukije Krasniqi – kur do të dalim nga kjo sallë dhe të shkojmë në objekt tjetër dhe e dyta, shqetësuese janë trotualet, jo vetëm që janë të penguar me automjete por tani gjatë verës të gjitha lokalet – kafiteritë me tavolina dhe karrige jashtë po pengojnë ato pak trotualet që kanë mbetur të lira, kështu që këmbësorët janë të detyruar të lëvizim në rrugë gjë që e rrezikon jetën e njerëzve por më së shumti janë të rrezikuar fëmijët. Çka duhet të bëjmë në këtë drejtim?

Smajl Latifi – unë kam nënshkruar një dokument me programin USAID në vlerë 7.500 € e dedikuar për rregullimin e sallës së re të Asamblesë me pajisje të nevojshme, mirëpo janë procedurat e tyre atë që po e vonojnë.

Avdullah Kryeziu – ka kaluar testi i maturës në Komunën e Rahovecit dhe rezultatet janë shumë të dobëta prandaj kisha pasur dëshirë që drejtoresha e DKA-së të përpilojë një Raport lidhur me shkaqet pse janë këto dobësi në testin e maturës ku mesatarja është 25.38%. E dyta, ne jemi dakorduar që zyrat e partive politike të bëhen gati, nuk kërkoj përgjigjet për sot por është afati i caktuar deri kur duhet të rregullohen këto zyre.

Smajl Latifi – e vërteta është që ky është realiteti që ka prodhuar këto rezultate në testin e maturës, por mund t'ju them që në 3 shkolla të mesme të Komunës tonë nuk është shkelur kriteri. Për sa i përket zyrave për subjektet politike, tenderi është shpallur dhe pritet të përzgjidhet fituesi.

Mbledhja ka përfunduar në ora 17,30.

K r y e s u e s i,
Kujtim Popaj